

FOTO: FERDI LIMANI

## LIBRI I PAVARËSISË

**SALI BASHOTA**

*Libri i Pavarësisë* ka një Shenjë të Artë: **LIBRI I PAVARËSISË**, Prishtinë, 17 Shkurt 2008 - Dita e Pavarësisë së Kosovës.

Dhe, ka Fletët e Bardha, në të cilat do të shkruhet nga Dorë e Njerëzve që e jetuan Çastin e Pavarësisë së Kosovës.

Janë ftuar tri personalitetet udhëheqëse të institucioneve kryesore të Republikës së Kosovës, Presidenti - zotëri Sejdiu, Kryeministri - zotëri Thaçi dhe Kryetari i Kuvendit - zotëri Krasniqi, që t'i shkruajnë fjalët e para të

Kapitullit të *Librit të Pavarësisë*.

*Libri i Pavarësisë*, po nis të shkruhet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës nga një pagjumesi ideale e njerëzve të Kosovës që e fituan Lirinë dhe të njerëzve të Shteteve të Botës që e ndihmuan Lirinë.

*Libri i Pavarësisë*, do të ketë historinë e vet më të admirueshme dhe më sublime, të mishëruar me Madhësitinë e Hyjnore: Qëndresën, Lirinë, Lavdinë, Paqen, Nderimin, Bekimin, Lumturinë...

*Libri i Pavarësisë*, do të shkruhet në gjuhën amtare dhe në gjuhët e popujve

miq të Kosovës, duke i renditur Dorëshkrimet si Shkrime të Shenjta, të cilat burojnë nga Mendimet dhe Fjalët më të bukura.

*Libri i Pavarësisë*, do të hyjë në librat më të çmueshëm të Kujtesës Kombëtare dhe të Kujtesës së Botës.

*Libri i Pavarësisë* "do të udhëtojë" nëpër institucione, akademi, familje, personalitete të Republikës së Kosovës; nëpër Ambasada të Shtetit të Kosovës; nëpër Shtetet e Botës dhe Diasporë.

Udhë të Mbarë *Librit të Pavarësisë!*

Prishtinë, 22 Shkurt 2008

# JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË 2008

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, organizojnë nga data 14 deri më 19 prill 2008 - Edicionin e gjashtë Java e Bibliotekës në Kosovë.

Manifestimi mbahet në Prishtinë, Prizren, Gjiilan. Organizohen seminare, ligjërata, ekspozita, promovime, donacione, përrurime.

Do të diskutohet për sistemin e automatizuar bibliotekar, rolin e bibliotekave digjitale, si të përdoret mënyra digjitale për ruajtjen dhe katalogimin e librave, si dhe tema që lidhen me kontekstin e zhvillimit të bibliotekave në Kosovë.

Në Javën e Bibliotekës përurohet Këndi Amerikan, Biblioteka e Re e Fakultetit të Filologjisë, dhe Projekti "Kujtesa e Kosovës".

Organizohet Dita e Dhurimit të Librit, ku donatorët mund të ndihmojnë me materiale trashëgiminë kulturore e Kosovës.

Gjatë Javës, implementohet Sistemi i Integruar Bibliotekar Aleph 500 në Bibliotekën Ndërkomunale "Fan Noli" në Gjiilan, nënshkruhet Akti i Ri i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë; promovohet Web-faqja e re e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës,



promovohet libri i Eqrem Çabej, me shkrime të botuara për herë të parë, si dhe botime të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Në Javën e Bibliotekës në Kosovë marrin pjesë përfaqësues të njohur të shkencës dhe kulturës të Kosovës dhe Shqipërisë, ekspertë ndërkombëtarë nga fusha e bibliotekarisë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera, si dhe ekspertë vendës, të cilët do të shkëmbejnë përvoja dhe ide të rëndësishme që shpalsin projektet e të ardhmes së bibliotekave në Kosovë.

Java e Bibliotekës në Kosovë është ngjarja më rëndësishme e vitit për kulturën dhe bibliotekat në Kosovë.

Në këtë numër



Dita e bekuar e Kosovës ..... 4

Libri i dëshmisë së jetës dhe fatit tonë..... 5

Roli dhe misioni i librit dhe i bibliotekave në dasporë ..... 6

Marketingu i Marrëdhënieve me Publikun dhe Biblioteka 2.0: Partneritet Strategjik..... 8

Libri shqip në Kosovë (1944 - 1984)..... 12

Etika e sjelljeve të bibliotekarëve që merren me libra të rrallë, dorëshkrime dhe koleksione të veçanta..... 16

BIBLIOTEKA  
KOMBËTARE  
DHE UNIVERSITARE  
E KOSOVËS



THE NATIONAL  
AND UNIVERSITY  
LIBRARY  
OF KOSOVA

[www.biblioteka-ks.org](http://www.biblioteka-ks.org)

**Botues:** BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota

**Kryeredaktor:** Fazli Gajraku

**Këshilli redaktues:** Besim Kokollari, Bukuriye Haliti

**Realizimi kompjuterik:** Extreme Studio

**Adresa:** Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë

**Tel:** ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** [biblioteka@biblioteka-ks.org](mailto:biblioteka@biblioteka-ks.org)


# U promovua Libri i Pavarësisë

Prishtinë, 22 shkurt 2008

**N**ë Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, më 22 shkurt 2008, është bërë promovimi i Librit të Pavarësisë. Në përkushtimin për të shënuar dhe ruajtur shenjat e kujtesës për Ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Rektorati i Universitetit të Prishtinës dhe PEN-Qendra e Kosovës, kanë promovuar Librin e Pavarësisë, libër në të cilën do të ruhen gjurmët, shenjat, simbolet, mesazhet e njerëzve që duan ta ruajnë e ta lënë në arkivin e këtij libri rrëfenjën e vet për Pavarësinë e Kosovës. Libri i Pavarësisë këtu e tash bëhet pjesë e trashëgimisë kulturore dhe historike të Kosovës.

Në Promovimin e Librit të Pavarësisë morën pjesë: Presidenti - Fatmir Sejdiu, Kryetar i Kuvendit - Jakup Krasniqi, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Enver Hoxhaj, deputetë të Kuvendit të Kosovës, si dhe përfaqësues të rëndësishëm të shkencës dhe të artit në Kosovë.

Në këtë manifestim, për konceptin dhe funksionin e Librit të Pavarësisë, folën: drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - Sali Bashota, rektori i Universitetit të



## Fjalët e para të shkruara në Librin e Pavarësisë

Prishtinës - Enver Hasani dhe kryetari i PEN-Qendrës së Kosovës - Basri Çapriqi.

Manifestimi është përshëndetur nga Presidentit - Fatmir Sejdiu dhe Kryetari i Kuvendit - Jakup Krasniqi, të cilët më pas i kanë shkruar fjalët e para në Librin e Pavarësisë.

Në këtë solemnitet të promovimit të Librit të Pavarësisë, kanë lexuar nga krijimtaria e tyre letrare, shkrimtarët: Adem Demaçi, Rexhep Qosja, Din Mehmeti,

Flora Brovina, Ali Podrimja, Sabri Hamiti, Milazim Krasniqi.

Në këtë promovim, i kanë shkruar fjalët në Librin e Pavarësisë edhe disa përfaqësuesit më të njohur të shkencës dhe të kulturës në Kosovë.

Manifestimi i Librit të Pavarësisë, është përcjellë me një program të zgjedhur artistik, në të cilin janë ekzekutuar pikë muzikore nga: Lule Elezi, Antonio Gashi, Venera Mehmetagaj - Kajtazi, Jeta Çitaku dhe Zana Abazi.



Presidenti i Republikës së Kosovës - Fatmir Sejdiu, duke shkruar fjalët e para në Librin e Pavarësisë



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës - Jakup Krasniqi, duke shkruar fjalët në Librin e Pavarësisë

# Dita e bekuar e Kosovës

ENVER HASANI\*

Sot është dita e pestë e pavarësisë së Kosovës, dita e fillimit të një jetë të re për të gjithë ne. Kjo ditë dhe ditët në vijim, për ne janë sikur ato ditët e fillimit të botës, ku cdo gjë është e re, e bekuar nga Zoti, sepse gjenerata të tëra u rritëm në robëri, nën dominimin dhe pushtetin e të tjerëve. Gjeneratat që vijnë kurrë nuk do të kuptojnë gëzimin tonë të sotëm dhe atmosferën që aktualisht mbretëron në cdo shtëpi, te cdo njeri, i rritur dhe fëmijë. Për ne që përjetuam këto momente vërtet historike, 17 shkurti i vitit 2008 paraqet ditë të bekuar nga Zoti, për ata që vijnë pas nesh, krijimi i shtetit të Kosovës do të jetë si dicka normale, sepse do të rriten në shtet të pavarur dhe sovran, me identitet të qartë ndërkombëtar. Në ishim herë sllav e herë jugosllav, e kishim të vështirë t'ua sqaronim të tjerëve jashtë se çfarë ishim dhe pse kishim mbetur pa identitet tonin. E vështirë ishte, sepse bashkëbiseduesit ishin njerëz të rritur në shtete dhe të lumtur e në prosperitet.

Ne duhet të jemi koshientë për këtë që u bë, jo vetëm sot, por edhe në të ardhmën. Tani e tutje ne futemi në konkurrencë me kombet e popujt e tjerë të barabartë të bashkësisë ndërkombëtare. Duhet të punojmë shumë dhe nuk duhet të shpenzojmë energji me të kaluarën e hidhur të vendit tonë. Luftën që e bëmë duhet t'ua lëmë gjeneratave që vijnë për t'u shërbyer atyre si lajtmotiv për ecje përpara dhe për zhvillim normal. Ne duhet të synojmë që të arrijmë kombet e civilizuar dhe të trajtojmë të tjerët ashtu sic kërkojnë standardet



Enver Hasani, rektor i UP-së, në fjalimin promovues të Librit të Pavarësisë

civilizuese të botës që i takojmë. Bashkësitë e tjera etnike që jetojnë në Kosovë janë shtetas tanë, të këtij vendi, sic jemi dhe ne, dhe të tillë duhet të ndihen dhe të jenë pjesë e barabartë e fatit tonë që na ka ndarë historia e Ballkanit. Zgjidhja e statusit të Kosovës tani nuk ka asnjë dyshim se do t'i qetësojë edhe të tjerët në rajon, kurse shoqërinë serbe, përkundër rezistencës aktuale, do ta rikthejë kah vetvetja dhe kah progresi. Shoqëria serbe ka qenë kohë të gjatë e preokupuar me ne, ka shpenzuar energji në ndërtimin dhe ruajtjen e një miti jocosivilizues, duke lënë pa lumturi, pa liri dhe jetë normale, si ne ashtu dhe veteveten. Serbët shumë shpejt do ta kuptojnë se në Ballkan nuk ka kombe të mëdha dhe të vogla, spese të gjithë janë të njëjtë në peshë dhe se cdo mentalitet imperial vetëm sa dëmton bartësit e tij, heret e vonë. Mësimin që shoqëria serbe e ka marrë me Kosovën duhet ta mbajnë mend të gjithë popujt e tjerë që synojnë hege-

moni në Ballkan, sot dhe nesër.

Dija që prodhon shoqëria ballkanike si tërësi, ka ardhur koha, që duhet t'u shërbejë qëllimeve universale njerëzore dhe të dalë nga konteksti i ngushtë ballkanik. Të gjithë duhet të angazhohemi në institucionet që drejtojmë për universalizimin e dijes ballkanike, sepse vlerat e Ballkanit si tërësi domosdo që kanë vlera universale. Këtij qëllimi zotohet se do t'i shërbejë edhe institucioni që drejtoj unë, në mënyrë që të gjithë së bashku të gjejmë vendin si të barabartë në gjirin e familjes evropatlantike të vendeve të lumtura.

Le të jetë Kosova njëmend shtet i qytetarëve të saj të barabartë, të gjithë shtetasve të saj.

Gëzuar Shtetin e ri të Kosovës! Lavdi atyre që punuan, vdiqën dhe u sakrifikuan për Kosovën e sotme!

Prishtinë, 22 shkurt 2008

\* Enver Hasani është rektor i Universitetit të Prishtinës. Ky fjalim është mbajtur më 22 shkurt 2008, me rastin e promovimit të Librit të Pavarësisë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

# Libri i dëshmisë së jetës dhe fatit tonë

**BASRI ÇAPRIQI\***

**P**o mbyllim sot një libër të vështirë, të rëndë, të shkruar gjatë, një libër me shumë vlerë për të gjithë ne. Ky libër që u mbyll më 17 shkurt ruan brenda njërin nga kapitujt më tragjikë të rajonit të Ballkanit të shekullit të kaluar, gjithë dhimbjen, gjithë lavdinë, gjithë aktet e kimit dhe gjithë madhështinë e humanitetit njerëzor, gjithë peshën e pushtimit po dhe gjithë energjinë e kërkimit të lirisë.

Librin të cilin do ta cmojmë shumë si dëshminë më me vlerë të jetës dhe fatit tone, nxitojmë ta mbyllim sa më parë. Nxiton ta mbyllë këtë libër kaq të rëndë edhe i gjithë komuniteti i civilizuar botëror. Këtë libër duan ta lënë të hapur ata të cilët ideuan, projektuan dhe zbatuan planet gjenocidale të shfarosjes dhe dëbimit të popujve në këtë pjesë të kontinentit tonë. Ky libër, që u mbyll më 17, shkurt ka brenda një argument të hidhur për racën e shkrimtarëve e që mbetet të dëshmojë për një histori morbide të angazhimit të shkrimtarëve në ideimin, projektimin dhe hartimin e memorandumëve gjenocidale e që u paraprinë aksioneve ushtarake në shfarosjen e popujve që u takonin etnive të tjera. Nuk mban mend historia e literaturës botërore një angazhim kaq të gjerë në numër dhe kaq agresivë në mjete, morbide e johumanë të shkrimtarëve, sa angazhimi i shkrimtarëve serbë në luftat e fundit të këtij rajoni e posacerisht në nyjën e Kosovës. Do të mbetet një kapitull i artë i këtij libri, roli



*Basri Çapriqi, kryetar i PEN-Qendrës së Kosovës, në fjalimin promovues të Librit të Pavarësisë*

shumëvjeçar i shkrimtarëve të Kosovës dhe gjithë inteligjencies së saj për të gjetur rrugën e lirisë edhe atëherë kur ajo dukej e pamundur, për të ruajtur besimin e këtij populli te një ditë e madhe që do të vijë edhe atëherë kur ajo dukej gati e pamundur dhe për të ruajtur vlerën e fjalës humane si gjënë më të shtrenjtë në një ambient terrori kur ajo gati ishte e pamundur. Kjo është një vlerë me të cilën ky vend pasuron thesarin human dhe civilizimin e kontinentit që i përket.

Zonja dhe zotërinj,

Po hapim sot këtë libër të madh në këtë tempull të dijes, të kulturës

e të civilizimit. Nisim të shkruajmë këtë libër të madh që do të mbetet i hapur gjatë e ku do të shkruhet një histori tjetër e këtij vendi, histori e paqës, e prosperitetit, e integritetit të mëdha, e barazisë së njerëzve e sidomos e gjuhës humane dhe mesazheve të paqes.

Z. President i Republikës

Z. Kryeministër i shtetit

Bëjeni të pamundurën që ky shtet i ri e i pavarur të jetë hapësirë e mjaftueshme për paqe, për jetë dhe lumturi të të gjithë njerëzve. Po nisim një libër të ri dhe duhet ta shkruajmë bukur.

*Prishtinë, më 22. 02. 2008*

\* Basri Çapriqi është kryetar i PEN Qendrës së Kosovës. Ky fjalim është mbajtur më 22 shkurt 2008, me rastin e promovimit të Librit të Pavarësisë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

# Roli dhe misioni i librit dhe i bibliotekave në diasporë

PROF. DR. SALI BASHOTA

1.

Duke e shikuar në rrafshin historik, Diaspora Shqiptare ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në inicimin, zhvillimin dhe funksionalizimin e vetëdijes kombëtare dhe të çështjes shqiptare në përgjithësi, pikërisht me aktivizimin e potencialit intelektual.

Gjithsesi, kolonitë shqiptare në shekullin XIX, veçanërisht në qendrat e Turqisë, Rumanisë, Bullgarisë etj., e sidomos Kolonia e Arbëreshëve të Italisë, e më vonë edhe Kolonia e Shqiptarëve të Amerikës, ndër të tjera, i kanë projektuar idetë nacionale, edukative, kulturore etj., duke u bërë qendra të fuqishme kulturore, në radhë të parë, për të sensibilizuar çështjen shqiptare dhe fatin e kombit, pikërisht përmes fushës së botimeve- librit dhe gazetave, të botuara në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të mëdha botërore.

Në fund të shekullit XX dhe në mileniumin e ri, roli dhe misioni i librit shqip në diasporë, ndryshon esencialisht, duke e ditur faktin se teknologjia moderne e komunikimit ofron një vizion tjetër në mënyrën e shfrytëzimit të burimeve e informacioneve dhe të vënies së kontakteve me librin, si dhe për faktin tjetër se ndihet mungesa e literaturës shqipe në diasporë.

Për të realizuar në mënyrë sa më efektive ofrimin e informacioneve për komunitetin shqiptar, i cili jeton jashtë atdheut të vet, bibliotekat mund të kryejnë funksione shumë të rëndësishme, duke u bërë njëkohë-

sisht qendra edukative, kulturore apo qendra të informacionit dhe gjithësi, ura ndërlidhëse mes popujve, kulturave e qytetërimeve të ndryshme.

2.

Rolin dhe misionin më funksional të organizimit të veprimtarisë edukative, mund të ketë një bibliotekë e një komuniteti, siç është rasti me komunitetin shqiptar, i cili ka një pjesëmarrje të madhe të popullsisë në një shtet, fjala vjen, siç është Zvicra, ku shqiptarët për nga numri i popullsisë konsiderohen si komuniteti i katërt në këtë vend.

Në këtë vit është themeluar biblioteka e parë shqiptare në Cyrih dhe mund të jetë një model mjaft i mirë edhe për vende të tjera, se si do të mund të funksiononte një bibliotekë për lexuesit shqiptarë dhe çfarë mundësisë do të ofronte ajo për përdoruesit e fondeve të saj, qoftë me ofrimin e literaturës së kërkuar për shfrytëzim apo për rëndësinë e aktiviteteve që do t'i realizonte.

Në këtë drejtim mund të krijohet një perspektivë e re, pikë së pari, në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave nacionale, pikërisht përmes kurseve për gjuhën. Organizimi i kurseve të shkrim-leximit në gjuhën amtare, por edhe në gjuhën e vendit ku jetojnë, si dhe aktivitetet e tjera me karakter edukativ, mund të kenë ndikim në vetëdijesimin e asaj popullate, në një ambient apo mjedis tjetër.

Pra, biblioteka, duke e kryer funksionin e qendrës së edukimit, ndër të tjera, do të përfshinte aktivitete edhe me karakter mësimor e dituror, pran-

daj koleksionet e saj do të mund të shfrytëzoheshin për forma të ndryshme të edukimit, sidomos për moshat më të reja. Prandaj, organizimi i veprimtarive me karakter edukativ në biblioteka është shumë dobiprurës edhe në relacionin shkolla-biblioteka, ku personeli i bibliotekës dhe mësimdhënësit do t'i koordinonin aktivitetet e tyre të ndryshme, në shërbim të lexuesve.

3.

Në botë ekziston fenomeni i tillë, ku bibliotekat shndërrohen në qendra të promovimit të kulturës nacionale dhe kulturave të tjera. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, do të mund të hartonin një strategji efektive, sa i përket mënyrës së realizimit të projekteve që kanë të bëjnë me njohjen, afirmimin, zhvillimin e kulturës nacionale, duke i prezantuar të arriturat e kulturës nacionale në Kosovë dhe Shqipëri e në viset tjera shqiptare, si dhe duke i prezantuar të arriturat e kulturës nacionale në diasporë.

Gjithsesi, biblioteka shqiptare në diasporë do të mund të luante rol dobiprurës sa i përket afirmimit të vlerave kombëtare përbrenda një regjioni tjetër gjuhësor. Aktivitetet do të përqendroheshin pikërisht në afirmimin e vlerave të krijuesve shqiptarë që jetojnë në ato mjedise, duke i favorizuar vlerat kombëtare, por edhe konceptet civilizuese e kulturore, si dhe format e integreimeve.

Organizimi i takimeve me shkrimtarë, ekspozitat, koncertet,

ligjëratat, debatet etj., do të krijonin mundësi për njohjen dhe afirmimin e komuniteteve, pikërisht duke i tërhequr edhe grupet e etnive të ndryshme, edhe aty ku ka diversitete kulturore, nacionale, fetare etj., për të mbërritur në konstatimin se biblioteka është dhe duhet të jetë në shërbim të çdo komuniteti.

#### 4.

Bibliotekat kudo në botë ofrojnë informacione për komunitetet të ndryshme, jo rrallë, duke i përshatur me kulturën dhe traditat e tyre. Madje, bibliotekat për të sjellë një informacion sa më efikas, në radhë të parë, ofrojnë materiale për të lexuar në gjuhën e tyre, pastaj në gjuhë të tjera. Ekzistojnë shembuj në shumë biblioteka evropiane e amerikane, ku bibliotekat ofrojnë botime që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve, për mundësitë e shkollimit, punësimit, për shëndetësinë, biznesin etj., madje edhe për përshtatjen e tyre kulturore në mjedisin e ri.

Kështu duke u bërë pika referuese të kontaktit me komunitetin, bibliotekat ofrojnë informacione praktike, duke krijuar faqe të internetit, ku përdoruesit do të kenë mundësi të informohen më të dhëna më të shpejta dhe më të sakta.

#### 5.

Nga ky kënd i vështrimit, mund të propozohen dy forma të funksionimit të bibliotekave me literaturë shqipe në diasporë. E para, ato mund të jenë të veçanta dhe të karakterit privat dhe e dyta, ato mund të jenë të integruara në kuadrin e bibliotekave shtetërore apo publike, në shtetin ku jeton komuniteti shqiptar. Funkzioni i tyre do të mund të jetë i dobishëm edhe nëse literatura shqipe, fjala vjen, do të mund të hynte brenda themelimit të

një Departamenti të Albanologjisë, në kuadrin e një biblioteke të atij vendi. Ky model është shumë funksional në disa shtete të Amerikës, por edhe të Evropës, sipas praktikave për komunitete të ndryshme.

Mundësia më efikase e funksionimit dhe e jetëzgjatjes së bibliotekave me literaturë shqipe, do të ishte nëse ato do të kenë mbështetje të përhershme me fonde librash e revistash nga Kosova e Shqipëria, pastaj me mbështetje të biznesit të shqiptarëve, në vendet ku jetojnë e veprojnë, si dhe me ndarjen e fondeve nga qeveria e atij vendi.

Ideja për themelimin e bibliotekave shqiptare në diasporë duhet të inicohet nga vetë komuniteti dhe të ketë mbështetje nga institucionet vendimmarrëse në vendin ku jetojnë, por gjithsesi edhe nga institucionet e Kosovës. Prandaj, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe me Ministrinë e Kulturës, është e gatshme të kontribuojë në projekte të tilla. Për më tepër themelimi dhe zhvillimi i bibliotekave të tilla, pa dyshim, do të mund të luante një rol mjaft të rëndësishëm në ofrimin e kulturave, në njohjen e qytetërimeve, në shkëmbimin e përvojave.

Procesi i globalizmit mund t'i zgjerojë komunikimet dhe afritë mes popujve apo herën tjetër mund t'i thellojë ndasitë, ndërsa faktorët kulturorë kombëtarë, gjithsesi, thelbin e vërtetë të vlerës e arrijnë në relacione ndërkombëtare. Në këtë drejtim, biblioteka si portë e dijës, do të kryente një funksion të rëndësishëm në jetën shoqërore të një populli: me informacionin, literaturën, shkëmbimin e njohurive, zgjerimin dhe përhapjen e dijës etj.

Shtrohet pyetja: Cili do të ishte funksioni i një biblioteke me liter-

aturë shqipe në diasporë?

Gjithsesi, funksioni kryesor i saj do të ishte edukimi i nxënësve, i studentëve apo dhënia e informacioneve me rëndësi për përdoruesit e saj, apo fundja shpëtimi nga kulturimi dhe asimilimi. Botimet e zgjedhura nga Kosova dhe Shqipëria, për të cilat do të kishin kërkesa lexuesit e bibliotekave të tilla, duke u bërë si ekzemplar i detyrueshëm, gjithsesi, do të ndikonin në një ndërlidhje më të fuqishme me atdheun, pra me gjuhën, historinë, kulturën, traditën etj.

Në këtë drejtim, do të ishte një projekt shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm themelimi i bibliotekave të pavarura në diasporë, pikërisht në qytetet e atyre shteteve ku prania e komunitetit shqiptar është më e madhe, natyrisht duke e organizuar dhe funksionalizuar edhe një rrjet efikas të shpërndarjes së librit me vlerë. Kontributi i institucioneve arsimore dhe kulturore të Kosovës, gjithsesi, do të ndikonte në realizimin sa më të shpejtë të iniciativës së tillë me rezultate konkrete.

Shkollat shqipe me mësim plotësues në diasporë, gjithsesi, do të mund të kryenin një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen e gjuhës, në kultivimin e traditave, në afirmimin e vlerave kombëtare, për të krijuar gjenerata të suksesshme, të cilat do të kontribuonin në shtetin ku jetojnë e veprojnë, por edhe për atdheun e tyre. Në ato qytete ku janë mbyllur shkollat shqipe me mësim plotësues, është e nevojshme që përsëri të hapen, ndërsa ato që janë duke funksionuar, është e domosdoshme që të mbështeten në të gjitha drejtimet, që fundja edhe libri shqip të bëhet pjesë e jetës së tyre.

*(Fragment nga një punim më i gjatë)*

# Marketingu i Marrëdhënieve me Publikun dhe Biblioteka 2.0: Partneritet Strategjik



**AIRA LEPIK**

*Aira Lepik është doktore e Shkencave të Bibliotekarisë dhe të Informacionit, profesreshë e asocuar në Departamentin e Studimeve Informative, si dhe shefe e Studimeve Postdiplomike të Shkencave Shoqërore në Universitetin e Tallinn-it, Estoni.*

*Ajo është përfaqësuese e Estonisë në komitete të ndryshme në nivel ndërkombëtar në fushë të Bibliotekarisë dhe Shkenca të Informacionit. Është themeluese e Këshillit për arsimim doktorature të Shoqatës së Universiteteve Evropiane; anëtare e komitetit të përhershëm të Seksionit për Edukim dhe Aftësim të IFLA-s, si dhe anëtare e Këshillit Hulumtues të Bibliotekës Kombëtare të Letonisë.*

*Aira Lepik, gjithashtu është anëtare e bordit redaktues të revistës "Journal of Research in Reading" (Britani e Madhe) dhe "Informacijos mokslai" (Lituani).*

*Fusha e saj e studimit shtrihet në Marketingun e shërbimeve të informacionit, Matja e performancës dhe menaxhmenti cilësor në bibliotekat akademike.*

*Ky shkrim ekskluziv është shkruar për revistën BiblioLetra*

## HYRJE: MARKETINGU DHE SHKENCAT E BIBLIOTEKARISË DHE TË INFORMACIONIT

Koncepti i marketingut është shtjelluar në literaturën profesionale të Shkencave të Bibliotekarisë dhe Informacionit (SHBI) që prej viteve 1970-ta. Parimet e marketingut u pranuan që atëherë në këtë disiplinë, dhe se përmbledhje relevante analitike mund të gjenden nëpër bibliografi notuese, të cilat përmbajnë informacione dytësore që prej asaj kohe deri më 2002 (Norman, 1982, 1989; Cox, 2000; Hamilton-Pennell, 2002; Owens, 2002).

Duke i analizuar botimet që kishin të bënin me marketingun e bibliotekave në literaturën profesionale, M. Cox, në vitin 2000, identifikoi trendët vijuese:

Një rritje në vazhdim të integrim-it të marketingut dhe proceseve planifikuese, theksim të nevojës për hulumtime të marketingut, një rritje në përdorimin e metodave pro-aktive në bibliotekari;

Një analizim të vazhdueshëm dhe të hollësishëm të koncepteve kryesore të marketingut: bazat e marketingut, analiza të marketingut dhe marrëdhënieve me publikun, reklamimet, elementet e përbashkëta dhe të ndryshme në komunikimin tregtar;

Një përshtatje në rritje dhe jetësim të metodave të marketingut të botës së biznesit në proceset e marketingut të bibliotekës;

Një analizim të përdorimit të mjeteve dhe metodave të reja të marketingut në zhvillimin e strategjive të marketingut të bibliotekave.

Pra, zbatimit i koncepteve të marketingut në fushën e SHBI-së ofron një potencial të madh në zgjidhjen e një varg çështjeve. Në veçanti, teoritë dhe metodat e marketingut i marrëdhënieve me publikun, mund të ndihmojnë bibliotekat në zhvillimin e strategjive të suksesshme për Bibliotekat 2.0.

## KONTRIBUT KONCEPTESH TË MARKETINGUT NË SHBI

Marketingu është identifikuar si një prej fushave kompetente me rëndësi për profesionistët e Shkencave të Bibliotekarisë dhe Informacionit, sipas shumë studimeve dhe projekteve, si: Planprogramet Evropiane në Shkenca të Bibliotekarisë dhe Informacionit (European Curriculum Reflections on Library and Information Science Education, 2005), Edukimi dhe Hulumtimi i Marketingut dhe Menaxhmetit Cilësor në Biblioteka (Education and Research for Marketing and Quality Management in Libraries, 2002), Udhëzimet IFLA-s për Programet Arsimore e Profesionale të Bibliotekarisë/ Informacionit (Guidelines for Professional Library/Information Educational Programs, 2000), etj.


Një rishikim i literaturës profesionale tregon qartë se konceptet dhe teknikat e marketingut janë bërë tema me interes dhe çështje me të cilat po merren profesionistët e SHBI-së, si për shembull: Gupta, Koonz, Massisimo, Savard (2006), Singh (2005), Walters (2004), de Saez (2002), Rowley (2001, 2006), Weingand (1998), - si dhe mësimd-



hënësit e SHBI-së - për shembull: Mahesh, Gupta (2006), Webber (2002, 2006), Mittermeyer (2002, 2006), Georgy, Lepik, Petuchovaite (2005), Bouthillier (2002), Savard (1988, 2000).

Ndërsa, pak libra mund të gjenen si tërësi që i përkushtohen marketingut në SHBI - ekzistojnë "udhëzues si të" për bibliotekarë, të cilët ofrojnë udhëzime hap pas hapi për secilën fazë përfshirëse të programit të marketingut të bibliotekës (Siess 2003, Walters, 2004), si dhe analiza të thella, të cilat kanë për synim të sigurojnë që profesionistët e informacionit dhe bibliotekarët t'i kuptojnë si duhet konceptet e marketingut dhe të zbatimit të teknikave të tij (de Saez 2002, Rowley 2006).

Literatura e marketingut në SHBI pasqyron një rritje të vazhdueshme të studimeve të fushës së marketingut. Nga fillimet e viteve 2000, studiuesit filluan që t'u kushtonin vëmendje çështjeve vijuese me interes studimi: qëndrimit të bibliotekarëve dhe profesionistëve të informacionit karshi marketingut (Koonz, Rockwood 2001), marketingut të brendshëm (Broady-Preston, Steel 2002), marketingut të marrëdhënieve me publikun (Besant, Sharp 2000; Maycock, Weech 2007), orientimit dhe zhvillimit të një kulture të tregut (Singh 2004), marrëdhëniet me publikun (Marshall 2001). Literatura e marketingut në SHBI, po ashtu, tregon një zhvillim nga diskutimet e përgjithshme të mbështetura kryesisht në aspekte funksionale të marketingut, drejt hulumtimeve në formë studimesh rasti të mbështetura në literaturën e menaxhmentit e që kanë të bëjnë më shumë me çështje strategjike. Megjithatë, nuk ka studime të cilat i përfshijnë prob-



lemet e dy këtyre sektorëve apo studime të cilat mbështeten në një afat të gjatë kohor, si dhe nuk ka ndonjë studim meta-analizë të kësaj natyre në SHBI.

#### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I MARKETINGUT TË NDËRTIMIT TË MARRËDHËNIEVE

Definicioni më i njohur dhe më i përdoruri i marketingut nga Philip Kotler thotë se: "Marketingu është një analizë, planifikim, jetësim, dhe kontroll i programeve të përpiluara për të krijuar, ndërtuar dhe mirëmbajtur shkëmbim marrëdhëniesh në të mirë të anasjelltë, me qëllim të caktuar, për të arritur objektivat e atij që bën marketing" (Kotler, Andreasen 1991, 15). Marketingu mund të shikohet ashtu siç e spikat Harmoni: "gjetja, diagnostifikimi dhe përmbushja e nevojave të klientës relevante përmes shkëmbimit të marrëdhëniesh në të mirë të anas-

jelltë, dhe duke arritur që këto të kryhen më mirë se sa konkurrentët" (Harmon, 2002, 61). Që të dy definicionet e përmendura theksojnë se marketingu është një shkëmbim marrëdhëniesh, por nuk ka ndonjë identifikim të qartë se çfarë marrëdhëniesh fshihen pas këtyre shkëmbimesh.

Marketingu i marrëdhëniesh me publikun është një formë e marketingut që u zhvillua si kundërpërgjigje e drejtpërdrejtë marketingu në vitet e 1960-ta dhe doli në skenë në vitet e 1980-ta, në të cilën vihej theks më i madh në ndërtimin e marrëdhëniesh afatgjata me konsumatorët, se sa vihej theks në transaksionet individuale. Përfshin një kupim të nevojave të konsumatorëve gjatë tërë ciklit të tyre të jetës. Thekson sigurimin e një varg produktesh apo shërbimesh të konsumatorëve ekzistues, sipas nevojës që ata e kanë (Morgan dhe Hunt, 1994).

Marketingu tradicional e ka vënë theksin më shumë në nxënien të sa më shumë konsumatorëve, mirëpo marketingu i marrëdhënieve me publikun i ka vënë theks më të veçantë rëndësisë së zhvillimit dhe mbështetjes së marrëdhënieve afatgjata me konsumatorët ekzistues, dhe mban qëndrimin se energjia dhe burimet të përqendrohen në kultivimin e tyre (Grönroos, 1997). Grönroos paraqet një kornizë të marketingut të marrëdhënieve me publikun, i cili në thelb ka një proces ndërveprues, një proces komunikimi të planifikuar, i cili mbështetet nga lloje të ndryshme të mediave, dhe të një procesi që e paraqet konsumatorin si vlerë si rezultat i marketingut

të marrëdhënieve me publikun (Grönroos 2000).

Në kontekstin e Shkencave të Bibliotekarisë dhe Informacionit (SHBI), përmes marketingut të marrëdhënieve me publikun vihet në dukje se:

Bibliotekave u kërkohet të shkojnë përtej nevojave, dëshirave dhe kërkesave të konsumatorëve të tyre, dhe se duhet të provojnë t'i përmbushin ato me parashikime sa më të largëta që është e mundur (Singh, 2003);

Marketingu i marrëdhënieve me publikun ofron të mira specifike për bibliotekat, dhe mund të zbatohet si një efekt i veçantë në marketingun e shërbimeve të bibliotekave digjitale (Henderson, 2005);

Bibliotekat duhet t'i kanë parasysh së paku gjashtë marrëdhënie dhe partneritete: konsumatorin, tregun, tregun e brendshëm, tregjet furnizuese dhe aleate, tregun referal, tregjet rekrutuese dhe ato të ndikimit (Besant dhe Sharp, 2000).

Si rrjedhojë, përqendrimi i marketingut të marrëdhënieve me publikun nuk ka të bëjë vetëm të fitojë konsumatorë për shkëmbime të njëanshëm, por të mbajë dhe ndërtojë lidhje domethënëse me konsumatorët si themel për marrëdhënie të vazhdueshme dhe afatgjata.

## KONCEPTI I BIBLIOTEKËS 2.0

Rrethanat informative, në të cilat po e kryejnë veprimtarinë bibliotekat sot, po ndryshojnë më shumë se kurrë më parë. Biblioteka bashkëkohore 2.0 është një koncept shërbimeve më ndryshe të bibliotekave me orientim drejt përmbushjes së nevojave dhe pritjeve të përdoruesve të saj. Brenda këtij kuptimi, biblioteka i ofron informacionet e saja kudo dhe kurdo që i kërkon përdoruesi i saj, si dhe përpiqet t'i eliminojë pengesat në përdorimin e shfrytëzimit të tyre. Biblioteka 2.0 mund të shihet si një kundërpërgjigje e bibliotekarëve karshi zhvillimeve përkatëse në Ueb 2.0, të atyre që quhen softuer shoqëror, si dhe të një ambienti përplot informacione që mund të shfrytëzohen përmes kanaleve më të lehta e të shpejta (Curran, Murray, Christian 2007).

Maness (2006) e përkufizon "Bibliotekën 2.0" si "zbatim të teknologjive ndërvepruese, bashkëpunuese dhe multi-mediale të uebit në shërbimet dhe koleksionet e bibliotekës të mbështetur në ueb", dhe sugjeron që ky përkufizim të përdoret nga bashkësia bibliotekare. Koncepti i Bibliotekës 2.0 u zhvillua duke e analizuar si një ndryshim me përdoruesin në qendër (Casey dhe Savastinuk, 2006), të përqendruar në shërbimet në ueb (Abram 2005), të orientuar nga bashkësia virtuale me përdoruesin në qendër (Maness 2006), dhe si një koncept, i cili vepron në bazë të pritjeve të përdoruesit bashkëkohor.

Një studim i vonshëm i Maness-it tregon se koncepti i Bibliotekës 2.0 mund të kuptohet po qe se ajo bibliotekë i ka së paku katër elemente thelbësore:



E ka përdoruesin në qendër,  
Siguron përvojë multi-mediale,  
Është e pasur në aspektin shoqëror,  
Është inovacion i përbashkët  
(Maness, 2006).

Habib e përkufizon Bibliotekën 2.0 kësi lloji: "Biblioteka 2.0 paraqet një varg shërbimesh të bibliotekës të përpiluara t'i përmbushin nevojat e përdoruesve të motivuara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga Ueb 2.0". Edhe ky përkufizim shpjegon se Ueb 2.0 nxit ndryshimet e nevojave të përdoruesve dhe të shërbimeve të Bibliotekës 2.0 që t'i plotësojë këto nevoja. Ky përkufizim përfshin zbatimin e të gjitha metodologjive të Ueb 2.0 dhe të teknologjive në biblioteka (Habib, 2006).

## PËRFUNDIM

Marketingu nuk është një lëndë e re në Shkencat e Bibliotekarisë dhe të Informacionit (SHBI), por se në të njëjtën kohë mendohet se nuk shfrytëzohet në shkallën e duhur. Marketingu është një metodë për t'i përmbushur dispozitat kryesore të misionit të bibliotekës, planifikimet e teknikat e ardhshme të saj. Konceptet e marketingut dhe marketingu i marrëdhënieve me publikun, në veçanti, ofrojnë një mundësi sfiduese për bibliotekat, veçanërisht për Bibliotekën 2.0 në drejtim të të kuptuari se si të zhvillohen strategji të suksesshme për partneritet perspektiv. Duke e përmblytur me fjalët e Crawford-it (2006), ai thekson se "ekzistojnë së paku gjashtëdhjetë e dy pikëpamje dhe shtatë definicione të ndryshme për Bibliotekën 2.0, dhe... se mbani një sy në idetë dhe mjetet të cilat filluan të zhvillohen jashtë fushës së bibliotekarisë - nëse nuk e keni bërë këtë deri më tash".

## REFERENCAT

- Abram, S. (2005). Web 2.0 — huh?! library 2.0, librarian 2.0. *Information Outlook*, 9 (12), 44-46.
- Besant, L., Sharp, D. (2000). Libraries need relationship marketing. *Information Outlook*, 4 (3), 17-22.
- Broady-Preston, J., Steel, L. (2002). Internal marketing strategies in LIS: a strategic management perspective. *Library Management*, 23 (6/7), 294-301.
- Casey, M., Savastinuk, L. (2006). Library 2.0. *LibraryJournal.com*, September 1, Available at: [www.libraryjournal.com/article/CA6365200.html](http://www.libraryjournal.com/article/CA6365200.html)
- Cox, M. (2000). Library marketing research trends – a survey: 1988-1999. Available at: [http://www.clmc.org/Research/\(20.12.2000\)](http://www.clmc.org/Research/(20.12.2000)).
- Crawford, W. (2006). Library 2.0 and "Library 2.0". *Cites & Insights*, 6 (2). Available at: <http://citesandinsights.info/civ6i2.pdf>
- Curran, K., Murray, M., Christian, M. (2007). Taking the information to the public through Libray 2.0. *Library Hi Tech*, 25 (2), 288-297.
- Grönroos, C. (1997). Value-driven relational marketing: from products to resources and competencies. *Journal of Marketing Management*, 13, 407– 419.
- Gronroos, C. (2000). *Service Management and Marketing: A Customer Relationship Management Approach*, 2nd ed. Chichester: John Wiley.
- Habib, M. (2006). *Toward Academic Library 2.0: Development and Application of a Library 2.0 Methodology*. A Master's Paper for the M.S. in L.S degree. University of North Carolina at Chapel Hill, School of Information and Library Science, November, 2006. Advisor: David Carr. Available at: <http://etd.ils.unc.edu/dspace/bitstream/1901/356/1/michaelhabib.pdf>
- Hamilton-Pennell, Ch. (2002). *Bibliography of Library Marketing articles 1999-2002*. Available at: [http://www.clmc.org/Research/\(08.01.2003\)](http://www.clmc.org/Research/(08.01.2003)).
- Harmon, G. (2002). The importance of marketing in the library and information science curriculum. *The Acquisitions Librarian*, 27, 61-79.
- Henderson, K. (2005). Marketing strategies for digital library services. *Library Review*, 54 (6), 342-345.
- Koontz, C., Rockwood, P. (2001). *Developing performance measures within a marketing frame of reference*. New Library World, 102 (1163/1164), 146-153.
- Kotler, P. Andreasen, A. (1991). *Strategic marketing for nonprofit organizations*. 4th ed. New Jersey: Prentice Hall.
- Maness, J. (2006). Library 2.0 Theory: Web 2.0 and Its Implications for Libraries. *Webology*, 3 (2), Article 25. Available at: <http://www.webology.ir/2006/v3n2/a25.html>
- Marshall, N. (2001). Public relations in academic libraries: a descriptive analysis. *The Journal of Academic Librarianship*, 27 (2), 116-121.
- Maycock, A., Weech, T. (2007). Relationship marketing and the academic library: preparing future librarians to market information services. In: *Marketing of information services. Proceedings of 15th BOBCATSSS symposium, Prague 29-31 January 2007, 299-309*. Prague: Charles University.
- Morgan R., Hunt S. (1994). The commitment-trust theory of relationship marketing. *Journal of Marketing*, 58, 20– 38.
- Norman, G. (1982). *Marketing libraries and information services: An annotated guide to the literature*. *Reference Services Review*, 10 (2), 69-80.
- Norman, G. (1989). *Marketing library and information services: An annotated guide to recent trends and developments*. *Reference Services Review*, 17 (1), 43-64.
- Owens, I. (2002). *Marketing in library and information science: A selected review of related literature*. *The Acquisitions Librarian*, 27, 5-31.
- Rowley, J. (2006). *Information marketing*. 2nd ed. London: Ashgate.
- Saez de, E. (2002). *Marketing concepts for libraries and information services*. 2nd ed. London: Facet Publishing.
- Siess, J. (2003). *The visible librarian: asserting your value with marketing and advocacy*. Chicago: American Library Association.
- Singh, R. (2004). *Branding in library and information context: the role of marketing culture*. *Information Services & Use*, 24, 93-98.
- Singh, R. (2003). *Developing relationship marketing with customers: A Scandinavian perspective*. *Library Management*, 24, 34-43.
- Walters, S. (2004). *Library marketing that works!* New York, London: Neal-Schuman.

**Përktheu: Besim Kokollari**

# Libri shqip në Kosovë

## (1944 - 1984)



**MR. TAHIR FONIQI**

*/vijon nga numri i kaluar/*

### VITI 1953 - VIT I VEPRAVE ORIGINALE

Botimi i letërsisë shqiptare në Kosovë, (në kohën e ish-Jugosllavisë), nis më 1947, me vëllimet: "Vjersha për shkolla fillore e paragjimmaze", hartuar nga Mehmet Gjevori, Stathi Kostari e Shefqet Veliu, "Tregime të shkurta" 1948, "Nga letërsija shqipe", mbledhur nga Hasan Vokshi e Idriz Ajeti, e "Vjersha të zgjedhuna për pionerë", mbledhur nga Mehmet Gjevori, 1951.

Mirëpo, vit shenjzues i botimit të kësaj letërsie na del viti 1953, me ç'rast botohen pesë vepra origjinale autoriale: Rexhep Hoxha, "Gjethetë reja" : (Vjersha për fëmij), ky është shkrimtari i parë shqiptar, i cili ka botuar libër në ish-Jugosllavi), Mark Krasniqi, "Prrallat e gjyshit", Lutfi Rusi, Mehmet-Ali Hoxha, "Vjersha për fëmij", Martin Camaj, "Nji fyell ndër male", Sitki Imami, "Drejt ditëve të reja" - tregime etj., të botuara në Prishtinë e në Shkup.

Nga këta tituj - tre janë për fëmijë, e dy për të rritur. Botimet e Prishtinës kanë dalë në 10500 kopje.

Për librin "Nji fyell ndër male" është ruajtur dëshmia se ka qenë i gatshëm për botim në gjysmën e parë 1952. Në fund të vjershës "Këcimi" ("Jeta e re", 1952, 4, 264-265), autori ka shënuar: nga përmbledhja "Nji fyell ndër male". Vëllimi "Nji fyell ndër male" ka 18 poezi: Vjershat kanë 1132 vargje strofash tri, katër e gjashtëvargëshe, rimash të ndryshme. Vëllimi është botuar në 2000 kopje me parathënie tri faqesh, shkruar nga prof. V. Dançetoviqi e një fjalorth dy faqesh.


Poezia 1953 - 1980. - Gjatë periudhës 1953 - 1980 janë botuar 112

tituj librash me poezi për fëmijë: vjersha, poema, poema përrallë, përralla në vargje etj. (fjala është për botimet e para). Janë botuar edhe 207 libra me poezi për të rritur. Gjithsej, për fëmijë e për të rritur kanë dalë 319 tituj 199 poetëve. Librat për fëmijë i kanë krijuar 67 poetë. Këto vëllime janë botuar në 278800 kopje. Ndërkaq përmbledhjet për të rritur i kanë krijuar 132 poetë. Këto përmbledhjet e poezish janë botuar në 407000 kopje.

Romani 1956 - 1982. - Romani i parë shqip, për fëmijë, në Kosovë, në kohën e ish-Jugosllavisë, është botuar më 1959 nga Rexhep Hoxha me titull "Lugjet e verdha", ndërsa ai për të rritur botohet më 1957 me titull "Rrushi ka nisë me u pjekë" i Sinan Hasanit.

Prej vitit 1956 deri më 1982, në Kosovë janë botuar 85 romane: 27 për fëmijë e 58 për të rritur të 35 shkrimtarëve. Këto romane janë botuar në 236500 kopje.

Drama (edhe në Maqedoni) 1958 - 1984. - Gjinia e dramës ka filluar të botohet më 1958 në Prishtinë: Tahir Jaha, "Eja, eja...", Lazër Lumezi, "Makaronat e shejtanit", Hivzi Sulejmani, "Miu në xhep".



Deri më 1984 janë botuar 53 tituj dramash, përkatësisht 134 pjesë teatrore: drama, komedi, skeqe etj. për fëmijë e për të rritur në tirazh rreth 73000 kopje. Këto pjesë teatrore i kanë shkruar tridhjetë e dy autorë.

Janë botuar edhe rreth 200 tituj: tregime, kritikë letrare, letërsi gojore etj.

Gjatë periudhës 1944 - 1984, nga letërsia në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi (në Kosovë e në Maqedoni), janë botuar rreth 400 tituj të veprave letrare: poezi, prozë, pjesë teatrore, kritikë letrare etj. Ndërsa, nga letërsia botërore e përkthyer - rreth 260 tituj në rreth 200000 kopje.

Në raport me produksionin botues të librit në Kosovë, 1984, letërsia prezantohet me rreth 1388 tituj ose 21.1 për qind: letërsia shqiptare 11.2 për qind, letërsia e popujve të ish-Jugosllavisë 6 për qind e letërsia botërore 4 për qind.

### PËRVEÇIME, CENSURIME, ANATEMIME, MANGËSI

**Përveçime.** - Martin Camaj është autori i librit të parë shqip me poezi për të rritur në Kosovë, përkatësisht ish-Jugosllavi - "Nji fyell ndër male", botuar më 30 maj 1953. Ky libër (e quajnë edhe poemë) ka 28 poezi dhe është botuar në 2000 kopje nga Shtëpia botuese "Mustafa Bakija" në Prishtinë.

Ndërsa romani i parë, i botuar nga Shqipëria në Kosovë, është "Afërdita" e Sterjo Spasses, botuar më 1956 në 2000 kopje. Po nga ky shkrimtar botohet kolana e parë romaneske më 1968 në tetë libra: "Pse!", "Afërdita", "Ata nuk ishin vetëm", "Afërdita përsëri në fshat", "Të fala nga fshati", "Kurora e rinisë", "Buzë liqenit", "Sokolesha e

tregime tjera". Kolana ka 2177 faqe shtypi ose 176 tabakë. Është botuar nga Rilindja, Redaksia e botimeve e Prishtinës në 6000 kopje. Tajar Hatipi e Agim Ibrani janë autorët e librave të parë të prozës humoristike-satirike, botuar më 1963: "Buni" e "Quo vadis, djalosh?" Ndërkaq, Rexhep Qosja njihet autori i parë i librit me kritika letrare me vëllimin "Episode letrare": eseje, Prishtinë, 1967, Vehap Shita - autori i vëllimit të parë me kritika teatrore me librin "Skena shqipe: zgjedhje kritikash teatrale (1953 - 1963)",

Prishtinë, 1964, Ramiz Kelmendi është autori i parë i prozës udhëpërshkruese me librin "Rrugët", 1967 etj.

**Censurime.** - Janë censuruar "Vjersha dhe poema" të Ndre Mjedës, Prishtinë, 1962, "Jehona e kohës" e Mark Krasniqit, Prishtinë 1972 e Tiranë, 1978 etj. Në librin e parë, poema "Liria" e Mjedës, botohet pa strofën e parë. Ndërsa nga poemthi "I tretuni", hiqen nga dymbëdhjetë vargje nga kënga e dytë, e katërt dhe e pestë. E nga poezia "Malli për atdhe", është hequr strofa e njëmbëdhjetë. Edhe poezia "Vera" botohet pa strofën e fundit, të katërtën. Ndërsa, nga libri "Jehona e kohës", botimi i tretë i plotësuar, kuptojmë se "Të dyja botimet kanë qenë mjaft të reduktuara, duke lënë anash një varg vjershash të



dorëshkrimit të ofruar për shtyp...".

**Anatemime.** - Janë anatemuar: "Kangë popullore shqiptare të Kosovë-Metohis I, (është konfiskuar fill pas botimit), 1951, romani "Gjarpijt e gjakut" i Adem Demaçit, 1958, romani "Njerzit" i Hivzi Sulejmanit, 1966, tregimet për të rritur "Kumbonaret" e Ramadan Rexhepit, 1963, "Romani pa kornizë" i Musa Ramadanit, 1975 etj.

Krijimi e studimi i letërsisë shqiptare në Kosovë, gjatë periudhës të cilën po e shqyrtojmë, është bërë me mangësi: zhanret letrare nuk janë krijuar njësoj, në sasi e cilësi; nuk janë prezantuar njësoj në botimet antologjike të ngjashme dhe në përkthimet në gjuhët e huaja; letërsia nuk është përcjellë me bibliografi adekuate.

# Historija e bibliotekave në Shqipërië

(Ky tekst është marrë nga revista *Hylli i Dritës, Shkodër, Vjeta XIII, XIV - Kallnduer 1937, 1938, dhe botohet në origjinal, pa ndërhyrjen e redaksisë*)

*/vijon nga numri i kaluar/*

## BUTRINTI

Nji tjetër qytet me rendësi i Shqipërisë klasike ish Butrinti, i cili u visëllua para luftës së Troadhës dhe u smadhua e u sbukurua prej të ikurve të Troadhës, duke u paguarë gjithë me emëra të moçme të Troadhës, massi nga pozicioni topografik i ngjante së gjithash Trijës së moçme.

Këtu gjeti shpërndhje e prehje Aenea para se të vinte në Itali, dhë u këndua i përmallshëm prej Vjershëtorit Roman Virgilit në Aenaidhën e tij. Ky qytet para disa kohësh njihesh fare pak në botën e përjashtme, veç se nga disa Arheologjër si nga Qirjakua i Ankonës, Zoto Mollosi, Petridhi, Mustoksidi, Nikolla Mystaqidhi prej Dhrovjanit të Delvinës dhe me 1916 u vizitua për të parën herë prej Llukë Karafilit, kur ish edhe nji vendë pyllë dafinash e disa të tjetret.

Tani ky qytet i vjetërsisë u be i njohur në gjithë botën e qytetëruar me anë të sbulimevet arheologjike që bëri Missioni Arheologjik Italian në Shqipërië. Ky qytet veç kshhtëllit të moçmë kish edhe nji Theatër lirik më të mirë se ay i Athinës, nji Askullapium (Spital – ose dispenser) pran theatros, nji frigidarium, musaike të ndryshme, nji Agora të famëshme, si edhe nji baptistër që është monadhik në Sinisin Ilirike.

Në rëhmijet që janë bërë gjer më sot janë gjendur shumë shtatue të gurt ku në disa prej tyre është shkruarë në këmbë edhe emëri i artistit “Zosithenis epijisen”. Në Theatër u gjenden shumë gurë të shkruarë me dekrete të ndryshme dhe me sentenca, mbishkrime e tjera dhe n’askullapium shumë dhurata prej qeramidhesh e disa të shkruara si edhe statue me libra në dorë të marun prej këti vendi para se këto vise të benin pjesë në Mbretërin t’onë: nga gjithë këto kuptohet fare mirë se ky qytet do të kishë edhe tembullin e diturivet bashkë me

Bibliotekën e tij si gjithë qytetet e tjera të vjetërsisë. Mos harojmë se ky qytet ish për disa kohë kryeqytet i Haonis dhe seli Mbretënore e Ahilidhvet dhë më pas për pak kohë edhe Kryeqytet i Hepirit.

Shpresojmë që sbulimet që janë dukë vashduarë të na nxierin shumë gjera me rendësi që edhe nuk dimë, koha do të na e tregojë, po unë mbesojë se Biblioteka do të ket qenë pranë theatros ose askullapiumit.

## EPIDHAMNI OSE DYRAHIUMI

Nji nga qytetet e moçmë dhe më të shënuarë në Brigjet Ilirjane të Shqipërisë Klasike ish qyteti i moçmë i Epidhamnit ose Dyrahiumit vendin e të cilit lart e posht e ze gati Durrësi i sotmë.

Nga të gjithë qytetet e Ilirisë Maqedhonijane ose Ilirisë së qytetëruarë, në kohrat e moçme përmendet Durrësi si qytet i shkëlqyer, tregëtar, qytetërim, përparim, industri dhe për toposesin e tij.

Shkrimtar të moçmë Grek e Latin i kanë kushtuar faqe të ndriçme të veprave të tyre me historin e rrefimin e këti qytetit. Njeriu mundet të shkruaj vullum të terë mbi historinë e këti qyteti dhe të mos munda të mbarojë landën mbi përshkrimin e tij. Romanët e moçmë këte qytet e quanin “taberna Aderiae: dhe në kohë të tyre ish qendra e udhëvet dhe vendi i dëfrimit e ndenja e aristokracisë Romane.

Në Durrës ndenji oratori i famëshmë i vjetërsisë Romane Ciceroni, i cili e quan Durrësin “Qytet i lirë dhe i shënuarë e në rast se zhurma e madhe e tij nuk do t’a lerë të qetë ka për të shkruarë gjetiu”. (Cicer. epist. ad familiar. 14, 1. 7, “Dyrahium veni, quod et libera civitas est in me officiosa et proxima Italiae. Sed si offendet me loci celebritas, alio me conferam”).

Nga adhurimi i moçmë që kishin Durraskët i pari ish Zeusi i ati, përendivët dhe pastaj vinte përendesha e mendjes Athinaja, Dhimitra dhe Hekuri.

Në Faltoen e Olimbies kishin nji Thisauro të tyre.

Në kohë t’Imperatorit Traian të Romës u krijue nji Bibliotek e shënuarë kështu na shenon shkrimtari L. Heuzey në vepren e tij “Archives des miss. scientif. P. 509”. “Les inscriptions mentionnent aussi aquaeduc construit par l’empereur Adrien et bibliotheque elevee vers le temps de Trajan”.

Shkrimtari Stefan Bysandinoi na përmend nji mjek të famëshmë të Fillonidhi Dyrrahinon i cili eksercitonte mjekësin në Durrës dhe ish shkrimtari i 45 veprave të ndryshme mjekësije.

Mua më ngjanë se Biblioteka do të ish para Imperatorit Trojan, dhe siç duket ky e organizoi dhe e shtojë këte si pas kohës, gjëja që më bind për këte është kjo, gjithë qytetet e moçmë gati po thuj se Tembullin e diturive ja kushtonin perëndeshës së Mendjes Athinas ose Minervës siç e quanin latinët, dhe Durrsakët si perëndi kryesore kishin Zeusin dhe Athinan, dhe siç duket Biblioteka u prish prej termetit e urindërtua prej Trajanit dhe do të qendrojë edhe shumë kohë pas asaj dhe kjo na bind, për arsye se shumë burra dijetarë kanë dalë prej Durrësi si para Krishtit ashtu edhe pas Krishtit.

Mbase gërmimet arheologjike no nji herë do të sbulojnë gjë mbi këte Bibliotek të famëshmë.

## FINIQI

Jo larkë limanit të Sarandës dhe qytetit të Delvinës duke shkuar për në Konispol gjendet fshati i Finiqit, i cili sot është përbërë prej pak shtëpijash dhe kasollesh.

Ky fshat në kohrat e moçme ish nji qytet shumë i famëshmë dhe më pas u bë Kryeqytet i gjithë Mollosisë dhe i Hepirit.

Finiqi para ca kohësh nuk dihesh prej të gjithvet si edhe Butrinti, veq sa prej disa studiosvet të historisë dhe të arheologjisë, po sot me anë të sbulimevet që bëri Missioni arheologjik Itakian u bë i njohur në gjith botën e qytetëruarë. Kështjelli i këti qyteti ish shtat herë më i mathë se ay Athinës së moçmë, dhe nga mbeturinat siç

duket u banua që prej kohës së gurit, se u gjenden shenja të kësaj epohe si edhe të epohave të tjera Pellagoilirike, prohelinistike, helinistike, Romane, Byzantine etj., dhe siç duket vendi i bukur i tij e lugina e begaçme e Delvinës i ka tërhequr njerzit në banim të tij. Ky qytet i vjetërsisë klasike u shkatërua shumë herë prej armiqësh të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm, dhe më në fundë prej moçalevet që gjenden posh tij si edhe prej ethevet e mishkonjavet që grinë banorët gjer sa mbeti një fshat i vogël. Nga jeta e këti qyteti nuk dimë shumë gjëra, vetëm dimë se ky qytet pati në gji të tij një Thisavros, theatër, sterna të epohës helinistike dhe romane, një baptister, murret e kështjellit, pyrgjet nekropojën etj. që po shulohen prej kasmës së arheologut.

Themistokliu politikani i moçmë i Athinës, kur iku prej Atdheut të tij, ardhni e banoji në hoborr të Mbretit Adhmit dhe ky e përcolli me nderime të posaçme gjer në Pyndë. Edhe trashëgimtari i këti Tharipa krijojë Parlament në Finiq dhe solli burra të ditur prej Greqije për t'u marrur vesh dhe për të stërvitur popullin në dituri e cila u shvillua në një gradë të lart.

Arheologu Dhrovjanit i ndyeri Nikolla Mystaqidhi në përshkrimet e tij të ndryshme mbi Finiqin thot se ish një qytet i shënuarë dhe mjaftë i përparuar, me hotele (ksenones), spitale, teatra, shkolla të kulturës së unguur dhe së lartë dhe ka nxjerë mjaftë burra të shënuarë në dituri. Këtu u nënëshkrua paqja nëmjet të Filipit të Vë Mbretit të Maqedhonisë dhe të Romanvet e të Etolvet. Këtu janë gjetur mbishkrime të ndryshme, si gurë varesh, dekrete, sentence, përmendore, tratate e tjera.

Nga këto kuptohet se do të ketë pasur edhe një Bibliotek të themeluar që në kohë të mbretit Tharipa, kur ky solli dijetarët për stërvitjen e popullit të tij natyrishtë po në atë kohë do të kete themeluarë edhe Bibliotekën e qytetit, se pa libra nuk munt të mësohesh populli, gjithashtu edhe theatra nuk do të eksistonte potë mos kishë vepra teatrale.

Diturija në këte qytet ish e vijshëmë së gjer sa u themelua e para Basillika e krishter prej Kostantinit të Math, nuk pushuan burrat e mësuarë në këte qytet ku pastaj u mblodhë librat në Manastirin e Shënkollit

për të mësuarë kallogjerët e asaj kohe, kjo gjë na ep të koptojmë se qyteti me domosdo do të ketë patur një Bibliotek siç patën edhe shoqet e saj të moçme, mbase rëhmijet arheologjike no një herë do të na hedhin no një dritë mbi këte themë.

## MESJETA DHE KOHA E RE

Për kohen e shkuarë vetëm këto lajme kemi mbi Bibliotekat, mbase nga rëmijet arheologjike që po bëhen prej Misionevet arheologjike dhe që do të bahen, munt të na dali no një lajmë më i sigurt nga ato që dimë gjer tani, e të na ndriçojë më shumë në të pritmen, tani le të hedhim një vështrim mbi kohën e Mjesjetës dhe Kohën e Re.

Në Mesjetë si qendër i mësimit ish in Monastiret e Kuvendit, të cilat ish in edhe të pajosura me Biblioteka të shënuara, ku ronin kallogjer që shkolin jetën e tyre duke kënduarë dhe duke shkruarë vepra, ose duke kopjuarë të vjetrat. Mbi këte themë nuk po shtojmë gjë, veç se po përkthejmë pjesa prej Kreit të parë te librit të quajtur "Peri ton en Iporo Agathoergimata" të Dr. Ioanu Lampridhu e shtypur në Athinë më 1880.

"Udhëheqës e të shenjtavet hierora të Hepirit (të vjetër e të ri) vetëmitar të nxehtë prej zellit të mësimt, kthyen celat e tyre në vatra dije dhe shkolla morale të popullit duke i ndihmuarë shumë dhe para pushtimit (1431) duke përmajtur jetën morale të popullit. Përgjithësishtë kleri e Hepiri dhe veçanerisht ay që rronte në vetëmi në për ermi-taxhet e tyre, u munduan shumë për kombin t'onë, duke mbajtur zellin të nxehtë si për Atdhenë ashtu edhe për dijen. Klerin e Hepirit në ato kohra të trubulla, e shquan deshira e madhe që patën për studimin e helenishtes së moçme, kurse, në vise të ndryshme të Lindjes shihen edhe grindje të ndryshme e të rrezikëshme theologjike; Jeromonahu i Hepirit për të lidhur dijen me fen, mësonte nga selija e tij e vobekët pa pagesë, se fjala krishtërim e kombësi janë sinonime dhe prej këtyre udhëheqësve Jeromonahve të shumve gojdhana ju rruajti emërat. Në rastë se trashëgimtarët e tyre të çmonin të paktën duke rruajtur dorëshkrimet të kuvendeve si dhe Bibliotekat e tyre, do të gjenden emërat e këtyre puntorve të palodhur. Po jeta e trashëguësve ose e këtyre të rinjve nuk ju pergjigjë kur qellim-

it për të cilën ish in krijuarë prej themeluesvet dhe dhuronjësve të ndryshëm të këtyre vendeve të shenja. Ata e lehtësuan rrugën dhe për ata që do të vinin pas pushtimit duke u tërhequr për shpëtimin e kombësisë dhe të fes dhe me anë të krijimit të Bibliotekave në për vise e fshehura, prej këti burrimi të pa shteruar nxuarë të pastajmi mendimet dhe mësimet shpëtimtare; po këta fatkeqësisht edhe dorëshkrimet i përdorën bashkë me librat për të ndezur zjarë, në këto kohra të fundme..."

... "Themeluësi i Kuvendit të Geromerit që ish eksarhi (në Çamëri) ish themeluarë prej Nilos Jerihiotit (Jerihio që moti është quajtur qyteti i Orikumit të moçmë massi ky u prishë prej tërmetevet, dhe Orikumi ish një qytet në vendin ku gjendet sot Pasha - limani i Vlorës në krahinën e Dukatit,) i cili para se të bëhesh murg kish tjetër emër dhe rrithte prej familjes së famëshme të Laskarvet të Konstantinopolit. Ky iku prej Kryeqytetit bashkë me të tjerë në kohë të Imperatorit Byzandin Mihail Paleologut, kur ky njohu si kryetar të gjithë kishavet Papën e Romës më 1277, - ardhni në epikrati (shtetin) e Sevastokratorit Joan Dhukës, - i cili kish mbetur besnik në zakonet dhe kish ngritur drapelin (flamurin) e Orthodhoksisë për të mos u bashkuarë me papen, e cila prapë dukesh se u bë me shtytjen e Mbretërve Norman të Napolit, që endëronin bashkimin e këtyre viseve me pushtetet e tyre. Nilua vizitujë shumë vise të Hepirit duke predikuarë zakonet e pleqvet dhe në fillim zuri vend në Jerihio që ish kundrejt Kaninës, duke ndërtuar këtu edhe një qeli, që u përdor si burim i mësimet të tij, dhe më pas vajti në vendet e qytetit të Filatit duke ngrehur Kuvendin e Gjiromerit më 1282 në katun omonim duke u ndihmuarë edhe prej bujarvet Nikolla Apsara dhe të AristPrhut Kapandhritit, duke dhenë mësim rrethet darovishtë. Qellimi i tij nuk vajti kot, dhe as fare nuk rra mbi gurë, se trashëgimtarët e tij mbajtën atje gjer në shekulli XVI, një kandil të ndriçmë me një Bibliotek mjaftë të shënuarë për ato kohë.>>

Kështu që prej atyre kohravet duket u bë zakonë që edhe Kuvende e Manastire të formojnë dhe të mbajnë Biblioteka për mësimin jo veç të Klerikvet po edhe të popullit.

**Bardhyli\***

\*Bardhyli është pseudonim i Llukë Karafilit (1893 – 1976), studiues dhe historian

## Etika e sjelljeve të bibliotekarëve që merren me libra të rrallë, dorëshkrime dhe koleksione të veçanta

“Standardet për etikën e sjelljeve të bibliotekarëve, të cilët punojnë me libra të rrallë, dorëshkrime dhe koleksione të veçanta”, u miratua si rregullore nga Bordi i drejtorëve të Shoqatës së Bibliotekave të Kolehëve dhe Hulumtuëse, një divizion i Shoqatës Amerikane të Bibliotekave, më 18 janar 1987, dhe u botua në buletin “C&RLNews” v. 48 (mars 1987), f. 134-35. Deklarata u përpilua, ashtu si ky rishikim, për të plotësuar Kodin e Etikës të përshtatur nga Shoqata Amerikane e Bibliotekave (Rregullorja 54.16). Pasi etika e sjelljeve të individëve duhet të mbështetet në kontekstin institucional në të cilin punojnë, ky rishikim i standardit shoqërohet me udhëzime për praktika institucionale në mbështetje të standardit.

Standardet për Etikën e Sjelljeve dhe udhëzimet shoqëruese kanë për qëllim që t’i bëjnë të njohur publikut dhe profesionistëve parimet të cilat e udhëheqin veprimtarinë e bibliotekave dhe bibliotekarëve që merren me libra të rrallë, dorëshkrime, dhe koleksione të veçanta. Deklaratat në këtë dokument u ndihmojnë në marrjen e vendimeve dhe të veprimeve, jo vetëm atyre që merren me profesion dhe të institucioneve të cilave u shërbejnë, por edhe atyre që merren me ruajtjen institucionale të pronave të rëndësishme kulturore.

Këto deklarata u shërbejnë atyre që merren me libra të rrallë, dorëshkrime dhe koleksione të veçanta në disa mënyra: “Standardet



për Etikën e Sjelljeve të Bibliotekarëve që merren me Libra të Rrallë, Dorëshkrime dhe Koleksione të Veçanta” përbëjnë një standard të sjelljes individuale që mbulojnë çështje të vështira etike, si konflikti i interesit dhe veprimtaria e personelit në fushën e mbledhjes, të vlerësimit dhe të marrjes me materiale të tilla. Materiali shoqëruës: “Udhëzimet për praktika institucionale, në mbështetje të këtyre standardeve”, e njeh faktin se sjellja individuale llogaritet në kontekstin institucional. Duke u bërë thirrje restauratorëve dhe administratorëve për nevojën që të zhvillojnë rregullore dhe procedura institucionale, Udhëzimet duhet t’i mbështesin në krijimin e një klime të tillë institucionale, që është në përputhje me etikën e sjelljeve dhe në kundërpërgjigje të sjelljeve etike në situata të tilla si në rast të vjedhjes ose falsifikimit. Udhëzimet kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme etike, veçanërisht, për bibliotekat me koleksione të veçanta, e jo fort shumë për çështjet e përgjithshme administrative të një biblioteke. Parimet e përgjithshme përcillen prej pikave të cilat përfshijnë koncepte më të gjera, pothuaj, në secilën fjalë.

Bibliotekat, të cilat janë përgjegjëse të kujdesen për libra të rrallë, dorëshkrime dhe koleksione të veçanta, kujdesen për to sipas modeleve të ndryshme administrative, duke filluar nga caktimi me

orar të shkurtuar të një bibliotekari, i cili ka detyra të tjera shtesë, krahas kësaj, e deri te krijimi në një divizion të veçantë ose edhe të një biblioteke më vete, e cila funksionin e vetëm të saj e ka kujdesin për koleksionet e veçanta. Këto biblioteke të koleksioneve të veçanta njihen me emra të ndryshëm, nga dhoma thesareshe e deri te emërtimet si qendra hulumtuëse. Termi “biblioteka të koleksioneve të veçanta” do të përdoret në këtë dokument për të nënkuptuar të gjithë modelet dhe emrat administrativ për këso lloj bibliotekash.

Organizatrat përgjegjëse për qeverisjen dhe administrimin e bibliotekave, po ashtu, njihen me emërtime të ndryshme, ashtu si vetë bibliotekat. Në këtë dokument “bibliotekë”, “biblioteka”, etj., duhet të nënkuptohen si “organizata përgjegjëse për qeverisjen dhe administrimin e bibliotekës”. Kudo që përdoren shprehje si: “duhet të krijohen procedura”, atëherë, kjo organizatë mban përgjegjësi për to.

Termet “material bibliotekar”, “koleksione”, “libra të rrallë dhe dorëshkrime”, e të tjera, nënkuptohen të gjitha njësitë grafike e jo-grafike, përfshirë libra të rrallë, dorëshkrime, fotografi, harta, vepra arti, artefakte dhe objekte të tjera, të cilat janë të përfshira në koleksionet e veçanta të bibliotekave.

Termi “drejtor i bibliotekës” nën-



kupton personin përgjegjës të bibliotekës si tërësi.

Termi "bibliotekar i koleksioneve të veçanta" përdoret në këtë dokument për të shënjuar personin e punësuar në një bibliotekë të koleksionit të veçantë. Shumica e çështjeve të diskutuara kanë të bëjnë drejtpërdrejt me veprimet të cilat zakonisht kryhen vetëm nga personeli profesional, por që i tërë personeli, që punon në biblioteka të tilla ka obligim të njëjtë për t'i respektuar standardet etike.

### **I. STANDARDET PËR ETIKËN E SJELLJEVE TË BIBLIOTEKARËVE QË MERRËN ME LIBRA TË RRALLË, DORËSHKRIME DHE KOLEKSIONE TË VEÇANTA**

Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta kanë pozitë të mirëbesimit që përfshin edhe përgjegjësi të veçanta për promovimin e hulumtimeve, duke ruajtur dhe mundësuar qasje në materialet nën kujdesin e tyre. Bibliotekarët e tillë, duke i jetësuar rregulloret e institucioneve të tyre, duhet t'i pranojnë dhe t'i vënë në jetë këto përgjegjësi sa më mirë që dinë në favor të institucioneve dhe publikut që ato institucione u shërbejnë.

Ruajtja e besimit të dhënë është thelbësore për funksionimin efektiv të bibliotekave të koleksioneve të veçanta, dhe bibliotekarët e koleksioneve të veçanta, duhet, me shkathtësi, ta mënjanojnë zvetënimin e këtij besimi. Ata duhet të veprojnë me integritet, dhe medoemos t'u largohen veprimtarive të cilat mund t'i komprometojnë ata ose institucionet për të cilat punojnë. Ata, veçanërisht, duhet të kujdesen sa i përket sjelljeve të veta dhe procedurave në bibliotekat ku punojnë, që mund të shpjerë deri te konflikti i interesit - një situatë e cila ndodh kur interesat personale dhe financiare të punëtorit janë në kon-

flikt apo duken të jenë në konflikt me përgjegjësitë zyrtare të punëtorit. Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta nuk duhet ta tërheqin, ndryshojnë apo ta ndrydhin gjykimin e tyre profesional, me qëllim që t'i përshtaten një vendimi menaxherial, por duhet të janë përgjegjës për t'u njohur me rregulloret e institucionit si dhe me ligjet në zbatim dhe t'i zbatojnë ato.

Është në interesin publik dhe në interesin e institucionit që bibliotekarët e koleksioneve të veçanta të përfshihen në të gjitha veprimtaritë hulumtuese profesionale e personale. Megjithatë, duke bërë ashtu, bibliotekarët nuk duhet të harrojnë se përgjegjësia e tyre e parë është që të zbatojnë të gjitha detyrat në mënyrë të plotë dhe të ndërgjegjshme që ua jep pozita e tyre në bibliotekë. Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta duhet t'i mënjanojnë konfliktet e mundshme të interesit dhe keqpërdorimin e emrit, reputacionit dhe pasurisë së bibliotekës.

Këto Standarde për Etikën e Sjelljeve janë përpiluar që të mbështesin zbatimin e parimeve të vëna këtu në situata ku kërkohet kujdes i jashtëzakonshëm për t'i mënjanuar konfliktet e interesit. Standardet identifikojnë kategori të caktuara të veprimtarive, si tregtinë, që për nga vetë natyra është e pa-etikë dhe nuk mund të mënjanojë paraqitjen e konfliktit të interesit. Në fusha të tjera të sjelljes, ku kërkohet gjykimi për ta udhëhequr sjelljen individuale, standardet japin shembuj, por jo dhe gjithëpërfshirës, për çdo situatë. Standardet nënkuptojnë që bibliotekari do të veprojë në pajtim me shpirtin dhe atyre që thuhet në këtë dokument.

### **AKTIVITETET PRIVATE NË MBLEDHJEN E MATERIALEVE**

Blerja, mbledhja dhe posedimit i librave dhe dorëshkrimeve nga bibliotekarët e koleksioneve të veçanta, nuk është e pa-etikë në vetvete. Këto veprimtari mund ta zgjerojnë diapazonin e diturive dhe të të gjykuarit të bibliotekarëve, dhe si të tilla nuk duhet dekurajuar. Megjithatë, çështjet etike mund të ngritën lidhur me mbledhjen e materialeve në rrafshin personal. Bibliotekarët duhet të kenë kujdes të veçantë e të shtuar kur mbledhin materiale të ngjashme me ato që institucioni i mbledh. Disa institucione parashohin masa të kufizuara e madje edhe ta ndalojnë një veprimtari të tillë të përfshirjes private në mbledhjen e materialeve bibliotekare nga bibliotekarët e koleksioneve të veçanta. Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta duhet ta njoftojnë me kohë personelin administrativ të bibliotekës sa i përket veprimtarive të mbledhjes së materialeve në rrafshin personal.

Në rastin e veprimtarive të mbledhjes në rrafshin personal, bibliotekarët e koleksioneve të veçanta mund të përfshihen në shit-blerjen e herëpashershme të materialeve me qëllim që t'i përtërijnë koleksionet e tyre, apo mund edhe t'i spastrojnë ato si tërësi. Meqë mund të ngritën çështje sa u përket pronësisë dhe konfliktit të interesit, për shkak të një shitje apo tregtimi të tillë, është obligim i bibliotekarit që ta njoftojë administratën e bibliotekës për shitjet apo tregtimin e planifikuar dhe të paraqesë para blerësve të mundshëm dëshmi të titujve, ose në raste të mungesës së dokumenteve të pronësisë, atëherë të paraqitet një deklaratë personale me shkrim që dëshmon pronësinë.

Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta nuk duhet t'i përdorin marrëdhëniet e tyre me punën për ta promovuar çfarëdo veprimtarie personale të mbledhjes së materialeve bibliotekare. Ata nuk duhet, për shembull, të përfitojnë nga zbritjet e çmimeve për t'i blerë për vete materialet, nëse ato veç janë porositur të blihen nga institucioni.

Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta nuk duhet të futen në konkurrencë me institucionin në të cilin punojnë në asnjë mënyrë, gjatë veprimtarisë së tyre personale të mbledhjes së materialeve. Nevojat për mbledhje të materialeve duhet të mbeten gjithnjë prioritet.

Duhet të kihet kujdes i jashtëzakonshëm në mënyrë që të shmanget çdo pështjellim i mundshëm mes mbledhjes së materialeve në rrafshin institucional e atij personal. Në këtë drejtim, porositë personale për libra dhe materiale të tjera të llojit të njëjtë, që mbledhen edhe nga biblioteka, duhet të bëhen nga adresa e shtëpisë, por jo nga adresa e bibliotekës, si dhe të faturohet dhe porosia të kryhet tek ajo adresë. Për më tepër, duhet të kihet kujdes i madh shmangies së ndonjë pështjellimi të mundshëm të pronësisë së materialeve. Vetëm ato libra personal dhe materiale të ngjashme, të cilat bibliotekarët e koleksioneve të veçanta i konsiderojnë të nevojshme gjatë punës së tyre, mund t'i sjellin në zyrat e tyre. Secili material duhet të shënjohej e identifikohet si personale, para se të hyjë në bibliotekë, dhe të deklarohen para dhe pasi të largohen nga biblioteka.

#### Tregtimi privat

Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta duhet t'u shmangen veprimtarive që duken apo ka mundësi që të vendosin përfitimin personal mbi

interesin e institucionit që e ka punësuar. Prandaj, është e pa-etikë për bibliotekarët e koleksioneve të veçanta që të merren me tregtimin e librave, dorëshkrimeve apo materialeve të tjera bibliotekare.

Tregtimi përkufizohet këtu si blerje e rregullt e librave, shitja dhe tregtimi i materialeve bibliotekare për të fituar. Ripërtëritja e koleksioneve personale, (shih seksionin e mësipërm) nuk konsiderohet si tregti. Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta nuk duhet, po ashtu, të jenë pjesë e rekomandimit të materialeve për blerje nga institucionet apo mbledhësit e ndryshëm, nëse kanë ndonjë interes të pashpallur financiar në ato materiale, e as nuk duhet të pranojnë ndonjë shpajmim ose dhuratat të padeklaruar apo e cila mund të jetë si komprometim nga shitësi apo blerësi i materialeve të tilla.

#### VLERË E MATERIALIT

Vlera e materialit është përkufizuar këtu si vlera monetare e një njësie apo koleksionit të një njësie. Vlerësimi i materialeve për qëllime të brendshme administrative nuk konsiderohet si vlerë e materialit.

Në rast të punës me dhurues, bibliotekarëve të koleksioneve të veçanta shpesh u kërkohet që të japin këshilla në treg për vlerën e librave dhe të dorëshkrimeve. Edhe pse është akt i lejuar që të ndihmohet në shfrytëzimin e mjeteve referale për këtë qëllim, bibliotekarët e koleksioneve të veçanta nuk duhet të merren me përcaktimin e vlerës monetare të ndonjë libri të rrallë, dorëshkrimi, apo materialeve në koleksionet e veçanta, as me kompensim e as pa kompensim. Identifikimi, origjinaliteti dhe përkrahimi (aspekte që kanë të bëjnë me përcaktimin e vlerës së materialit),

kur bëhen si veprimtari jashtë bibliotekës, duhet të përshkruhen saktësisht me rregulloret të bibliotekës.

#### DHURATAT, FAVORET, ZBRITJET E ÇMIMEVE

Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta nuk duhet të pranojnë dhurata, hua ose ndonjë formë tjetër, ose ndonjë gjë me vlerë, e cila ndërlidhet me përgjegjësitë dhe detyrat që i kanë në institucionin ku punojnë. Rrogat, së bashku me benificionet relevante standarde, duhet të shihen si kompensim i plotë për bibliotekarët për të gjitha veprimtaritë në bibliotekë. Dhurata nënkupton edhe ofrimin e çmimit më të ulët gjatë blerjeve private nga furnizuesit që i shesin apo i kryejnë shërbime bibliotekës ku punon bibliotekari, përveç në rast se zbritje të tilla i ofrohen në mënyrë të rregullt edhe publikut në përgjithësi.

Dhënia e dhuratave personale mund të vijë edhe nga individë, të cilët mund të kenë ndonjë interes financiar apo interes tjetër në bibliotekë. Në situata të tilla, bibliotekari është i obliguar t'ia shpalosë drejtorit të bibliotekës të gjitha rethanat në të cilat ndodh një gjë e tillë.

Hulumtimet private, punësimi dhe dhënia e këshillave jashtë bibliotekës, përfshirë dhënien mësim, ligjërimin, shkrimin dhe veprimtaritë e tjera krijuese

Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta i kanë të drejtat e njëjta si personat e tjerë profesional për t'u angazhuar në hulumtime private dhe punësim jashtë institucionit në pajtim me rregulloret në fuqi të institucionit dhe bibliotekës.

#### HULUMTIMET PRIVATE

Hulumtimet private dhe veprimtaria botuese e bibliotekarëve të koleksioneve të veçanta duhet të inkurajo-

het në interes institucional, për ta shtyrë përpara fushën e hulumtimeve, e cila mundësohet nga koleksionet e bibliotekës. Nuk është e pa-etikë që një bibliotekar t'i shfrytëzojë koleksionet hulumtuese të bibliotekës për hulumtime private dhe botim në bazë të kushteve të njëjta me të tjerët, të cilët e përdorin po atë koleksion. Çdo perceptim i ndonjë konflikti të interesit mund të shmanget duke e bërë këtë veprimtari të njohur publikisht, ose duke i njoftuar autoritetet e caktuara të administratës. Megjithatë, është e pa-etikë që një bibliotekar t'i shfrytëzojë të drejtat e tij të veçanta për qasje në, ose për informacionet që nuk janë të hapura për publikun, materialet hulumtuese bibliotekare për hulumtimet e tij private apo të zhvillojë veprimtari botuese në një konkurrencë të pabarabartë me studiuesit e tjerë.

Interesi pronësor i bibliotekës dhe bibliotekarit në të drejtën autoriale, kompensimin e autorëve, dhe në të drejta të ngjashme duhet të jetë në pajtim me rregulloret e përgjithshme valide të institucionit.

### PUNËSIMI JASHTË BIBLIOTEKËS

Të gjitha veprimtaritë lidhur me punësimin jashtë institucionit duhet të bëhen mbi bazën se përgjegjësia primare e bibliotekarit është në bibliotekë, që veprimtaria jashtë saj nuk e detyron bibliotekarit që të zhvishet nga kjo përgjegjësi, dhe se nuk do ta komprometojë integritetin profesional dhe reputacionin e bibliotekës. Nuk duhet t'i referohet pozitës zyrtare që e mban në bibliotekë ose kjo të bëhet në mënyrë të kufizuar, kur ka të bëjë me veprimtaritë jashtë bibliotekës.

Lloje të caktuara të punësimit jashtë bibliotekës, përfshirë dhënien e mësim-it, ligjërimin, shkrimin dhe të këshillave,

mund të jenë në të mirë edhe të institucionit dhe të punëtorit, duke nxitur zhvillim profesional. Si rrjedhojë, bibliotekarët e koleksioneve të veçanta duhet të inkurajohen që të marrin pjesë në këto veprimtari. Në institucionet akademike ekzistojnë rregulloret, të cilat e rregullojnë çështjen e punësimit dhe të dhënies së këshillave jashtë institucionit për personelin akademik dhe të tjerët; bibliotekarët e koleksioneve të veçanta duhet t'u nënshtrohen rregulloretë të njëjta.

Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta, shpesh, mund të shihen si përfaqësues të institucioneve të tyre, përderisa janë të angazhuar në veprimtari dhe detyra të ngjashme me atë që kryejnë në bibliotekën ku janë të punësuar me orar të plotë, edhe pse puna e tyre mund të jetë tërësisht e pavarur prej institucionit. Në raste të tjera, veprimtaritë e bibliotekarit jashtë institucionit mund të kenë lidhje të pakta me funksionin e një biblioteke. Cilado situatë që të jetë, bibliotekarët e koleksioneve të veçanta duhet t'ia bëjnë të ditur drejtorit të bibliotekës apo mbikëqyrësve të tyre veprimet lidhur me punësimin e planifikuar dhe dhënien e këshillave si konsultantë jashtë biblioteke.

### SHFRYTËZIMI PERSONAL I BURIMEVE TË BIBLIOTEKËS

Miratim paraprak duhet të kërkohet nëse shfrytëzimi i burimeve të bibliotekës, si mjetet hulumtuese, shfrytëzimi i ndihmës së personelit tjetër, shfrytëzimi i telefonit, fotokopjuesve, kompjuterëve apo i pajisjeve e objekteve nga koleksionet bibliotekare, bëhet lidhur me veprimtaritë jashtë saj. Po ashtu, duhet të rregullohet edhe mënyra e kompensimit të institucionit për një shfrytëzim të tillë sipas rregulloretë të institucionit.

Asnjë bibliotekarë i koleksioneve të veçanta nuk duhet të shfrytëzojë në

shtëpi ndonjë objekt apo material që është pjesë e koleksioneve të bibliotekës apo pjesë e koleksioneve të mbyllura dhe e cila nuk u jepet në shtëpi për shfrytëzim përdoruesve të tjerë dhe publikut, apo shfrytëzimin e ndonjë prone, mjeteve apo burimeve të bibliotekës, përveç shfrytëzimit zyrtar në institucion. Në rast të ndonjë rrethane të veçantë bëhen përjashtime, atëherë ato duhet të janë të parapara e të dokumentuara me shkrim.

### KONFIDENCIALITETI

Bibliotekarët e koleksioneve të veçanta, puna e të cilëve paraqet njohjen me punën e hulumtuesve, marrëdhëniet e bibliotekës me dhuruesit e libërshitesit, si dhe me çështje të tjera të natyrës konfidenciale, duhet të ushtrojnë kujdes në respektimin e të drejtës private për informacion.

Në pajtim me rregulloren e Shoqatës së Bibliotekave Amerikane (S52.4, Konfidencialiteti i materialeve bibliotekare), bibliotekarët e koleksioneve të veçanta duhet ta respektojnë të drejtën private të lexuesve të tyre lidhur me veprimtarinë dhe hulumtimet që i bëjnë, pasi i mësojnë ato si rrjedhojë e detyrave që i kanë përgjegjësi. Mund të bëhen përjashtime në këtë dispozitë në raste kur, për përparimin e hulumtimeve, lexuesi e ka nënshkruar ndonjë marrëveshje me shkrim që i heq të drejtën private për informacion në çfarëdo situatë.

*(Në numrin e ardhshëm: "Udhëzime për praktika institucionale në mbështetje të këtyre standardeve")*

Marrë nga:

<http://www.ala.org/Template.cfm?Section=speccollections&template=/ContentManagement/ContentDisplay.cfm&ContentID=8969>.

**Përktheu: Besim J. Kokollari**

# Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit në rrjetin e Programit Aleph 500\*

**SALI BASHOTA,**  
**DREJTOR I BKUK-së**

**B**iblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka në përdorim programin e automatizuar bibliotekar, Aleph 500, njërin ndër programet më të avancuara në botë në fushë e bibliotekave, i cili është në përdorim në mëse 50 shtete të botës, me një shtrirje të madhe, sidomos, në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. BKUK ka blerë këtë program nga kompania Ex Libris, me seli në Londër, më 15 mars 2004 dhe deri më tani janë futur në bazën e të dhënave mbi 35 mijë njësi bibliografike.

Prizreni, njëri ndër qytetet më të bukura të Republikës së Kosovës, i cili sivjet kremton 130-vjetorin e Lidhjes Shqiptare së Prizrenit, i njohur që nga viti 1944 si vendlindja e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, sot e ka një ditë të veçantë dhe të gëzuar për të gjithë lexuesit e vet, sepse do ta ketë licencën e parë të sistemit të automatizuar bibliotekar, prandaj Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit, i urojmë mirëseardhje në programin Aleph 500.

BKUK, e cila, ndër të tjera, është edhe qendër e organizimit dhe e menaxhimit të rrjetit bibliotekar në Kosovë, ka vendosur që ta shtrijë rrjetin e programit bibliotekar Aleph 500 në bibliotekat ndërkomunale të Kosovës: Prizren, Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, duke ofruar shtatë licenca falas për këto biblioteka.



*Çast nga ceremonia përruese e instalimit të licencës së parë të Programit Aleph 500 në Bibliotekën Ndërkomunale në Prizren*

Po kështu, programi Aleph parashihet të shtrihet edhe në të gjitha bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, pastaj në Bibliotekën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bibliotekat e institucioneve më të larta shkencore e kulturore etj., në mënyrë që të krijohet katalogu përmbledhës i materialeve bibliotekare në Kosovë.

BKUK ka arritur që, me një përkushtim të madh, bashkë me Kompaninë Ex Libris - me seli në Londër, të krijojë stafin profesional të Aleph-it për Kosovën, duke ofruar edhe trajnime në komponentet kryesore të sistemit të automatizuar bibliotekar, qoftë në fushën e menaxhimit, qoftë në fushën e shërbimeve

dhe të përdorimit.

Besojmë dhe shpresojmë se BKUK në mbështetje dhe bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës dhe Universitetin e Prishtinës, si dhe me Kompaninë Ex Libris me seli në Londër, do të arrijë suksese në realizimin e këtij projekti për bibliotekat e Republikës së Kosovës.

Urime dhe Gëzuar Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit!

Ju urojmë mirëseardhje edhe bibliotekave të tjera në Aleph 500.

*(Fjalë në përrurimin e licencës së Programit Aleph 500, në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit, më 28 shkurt 2008)*

## Workshop në Bibliotekën e Artit Bashkëkohor

Prishtinë, 22 janar 2008

**N**ë projektin për sensibilizimin e opinionit artdashës të Kosovës për rolin dhe misionin e Bibliotekës së Artit Bashkëkohor, artistja nga Gjermania Elke Marhofer ka mbajtur një workshop më 22 -23 janar, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të kulturës dhe të artit, si dhe pedagogë dhe studentë të Universitetit të Prishtinës

Fondi i Bibliotekës së Artit Bashkëkohor është kryesisht në gjuhën angleze dhe gjermane dhe përfshin rreth 9 mijë tituj: libra, enciklopedi, katalogë, revista dhe materiale të tjera për artin, si dhe 30 filma artistikë, dokumentarë e video, që janë dhuruar nga artistë të vendeve të ndryshme. Ky fond është në dispozicion të të gjithë përdoruesve të interesuar në fusha të ndryshme të artit bashkëkohor.

Fondi i kësaj Biblioteke, që është në një hapësirë të veçantë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, është krijuar nga Adrian Williams, Shannon Bool, dhe Judith Raun, me ndihmën e Zyrës Gjermane në



*Çast nga një takim në workshopin në Bibliotekën e Artit Bashkëkohor*

Prishtinë. Pjesa më e madhe e librave është dhuratë personale e njerëzve të artit, nga të cilët është kërkuar që, pos librave dhe katalogëve të tyre personale, të dhurojnë edhe libra të tjerë për këtë projekt. Projekti është në zhvillim dhe është premtuar për pasurimin e kësaj biblioteke me tituj të rinj.

Drejtori i BKUK-së, Sali Bashota, ka premtuar, se, përveç ndihmës që do të jepet në pasurimin e fondit të kësaj biblioteke, hapësirat e kësaj biblioteke do të jenë në shërbim të profesorëve, studentëve dhe artistëve, për të zhvilluar punë kreative, takime e debate me interes për

ta.

Krijimi i komunikimit mes artistëve nga Kosova dhe atyre ndërkombëtarë, ka qenë arsye e mjaftueshme që projekti të marrë edhe përkrahjen e Zyrës Gjermane në Prishtinë.

“Zyra Gjermane e përkrah këtë Projekt, sepse kjo gjë e fillon një dialog të ri, ndërmjet artistëve vendës dhe artistëve gjermanë dhe ndërkombëtarë. Ky është një lloj dialogu jo përmes kopertinave të librave, po përmes njerëzve që lexojnë këta libra”, ka thënë Monika Lenhard, referente për kulturë në Zyrën Gjermane në Prishtinë.

## Ceremoni solemne në përfundim të projekti të OSBE-së për BKUK

Prishtinë, 29 janar 2008

**Ë**shtë mbajtur një ceremoni solemne me rastin e përfundimit të Projektit të OSBE-së për përmirësimin e cilësisë në BKUK, që përfshin fushat, si: menaxhim më të mirë dhe përmirësim të procesit të rrjedhës së punës; lehtësim dhe mirëmbajtje të praktikave më të mira, inkurajim dhe zhvillim të mëtutjeshëm të stafit, si dhe të rritjes së cilësisë së përgjithshme të shërbimeve në të mirë të përdoruesve akademikë.

Drejtori i BKUK-së, Sali Bashota, këtë projekt e cilësoi të një rëndësie të veçantë për zhvillimin dhe modernizimin e shërbimeve në BKUK. Ndërsa, Ambasadori i OSBE-së - Tim Guldiman shprehi kënaqësinë për vazhdimin e projekteve të tilla të bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lart e veçanërisht me BKUK-në. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Z. Enver Hoxhaj theksoi se është shumë i nderuar me rastin e përfundimit të një pjese të projektit, i cili është një fillim shumë i rëndësishëm

në modernizimin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ai shprehu gatishmërinë e tij për ta ndihmuar bibliotekën në projektet e ardhshme.

Me rastin e përfundimit të suksesshëm të këtij Projekti, drejtori Sali Bashota, ndau mirënjohje dhe falënderime për kontribuuesit e këtij Projekti: ambasadorin e OSBE-së në Kosovë - Tim Guldimmann, zyrtarin e OSBE-së - Francesco Bigagli, dhe Genc Kusari, si dhe nga Departamenti i Asistencës - Wilam Theuws.

## OSBE-ja ndihmon pasurimin e koleksioneve të bibliotekës “Latif Berisha” në Mitrovicë

Mitrovicë, 14 shkurt 2008

OSBE-ja i ka dhuruar Bibliotekës Ndërkomunale “Latif Berisha” në Mitrovicë mbi 500 ekzemplarë libra në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e komuniteteve që jetojnë në këtë komunë, në një vlerë mbi 7 mijë euro.

Në ceremoninë e dhurimit të këtyre

titujve, Tim Guldiman, shef i OSBE-së, ka përshëndetur iniciativën që është në funksion të vizionit për një trashëgimi të përbashkët kulturore, që promovon mirëkuptimin dhe dialogun e shoqërisë demokratike të Kosovës.

Për rëndësinë e këtij bashkëpunimi dhe vlerën e këtij koleksioni, ka folur edhe Drejtori i Bibliotekës Ndërkomunale në Mitrovicë, Hajrullah

Mustafa, i cili ka falënderuar OSBE-në për donacionin, si dhe KFOR-in, që ka ndërmarrë iniciativën për t'i dërguar librat, sipas kërkesave të përdoruesve, nëpër fshatrat më të larta ku nuk ka mundësi të lëvizë bibliobusi i bibliotekës. Këtë iniciativë e ka përshëndetur edhe Komandanti i KFOR-it, Christian Dekster, si dhe Nënkrjetari i KK të Mitrovicës.

### Programi ALEPH 500 - në Bibliotekën Ndërkomunale në Prizren



Takimi solemn me rastin e instalimit të Programit Aleph 500 në Bibliotekën Ndërkomunale në Prizren

Prizren, 28 shkurt 2008

Programi i automatizuar bibliotekar ALEPH 500, pas implementimit dhe zhvillimit në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, që është qendra e organizimit dhe menaxhimit të rrjetit bibliotekar në Kosovë, ka filluar të shtrihet, për herë të parë, në Bibliotekën Ndërkomunale në Prizren.

Në ceremoninë përuruese të instalimit të licencës së parë të Programit Aleph 500 në bibliotekën në Prizren, ishin të pranishëm drejtori i BKUK-së, Sali Bashota, zëvendësministria e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Lirije Kajtazi, këshilltari i kësaj ministrie - Kujtim Shala, si dhe përfaqësues të lartë të Komunës së Prizrenit.

Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit, tash do të mund të fillojë përpunimin e njësive bibliotekare në Programin Aleph, që përbën mbi 90 mijë ekzemplarë. Ky është hapi i parë i krijimit të katalogut të përbashkët në nivel të Kosovës.

### Është themeluar Këshilli Kombëtar i Bibliotekave

Prishtinë, 3 mars

Me vendimin e ministrit të Kulturës, Skënder Hysenit, është themeluar Këshilli Kombëtar i Bibliotekave. Këshilli është themeluar në bazë të Ligjit për Bibliotekat dhe përbëhet nga tetë përfaqësues të institucioneve: Kujtim Shala, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ramë Vataj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Osman Gashi, Rektorati i Universitetit të Prishtinës, Mehmet Kraja, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Izet Avdyli, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Sylejman Pireva, Biblioteka Ndërkomunale e Prishtinës, Drita Millaku, Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës dhe Bajram Shatri, Shoqata e Botuesve të Kosovës.

Këshilli Kombëtar i Bibliotekave, përveç që do të japë mendime, sugjerime dhe propozime për konceptimin e projekteve zhvillimore të bibliotekave, funksionimin e rrjetit bibliotekar dhe të bashkëpunimit ndërbibliotekar, do të mbikëqyrë krijimin dhe mirëmbajtjen e katalogut përmblendhës bibliotekar, kriteret themelore për pasurimin e koleksioneve, për kërkesat financiare të bibliotekave, projektet për veprimtarinë e bibliotekave etj. Këshilli, gjithashtu, ka në përgjegjësinë e vet të sugjerojë programe për aftësim profesional, vendosjen e titujve profesionalë, kushtet dhe procedurën e dhënies së provimit profesional, shqyrton raportet vjetore të bibliotekave, punën e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe të drejtorëve të bibliotekave ndërkomunale etj.

## Programi ALEPH 500 - në Bibliotekën Ndërkomunale "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë

Prishtinë, 14 mars 2008

Më 14 mars 2008 u instalua Programi i automatizuar bibliotekar Aleph 500 edhe në Bibliotekën Ndërkomunale "Hivzi Sylejmani" të Prishtinës. Instalimi i këtij programi, sipas z. Sylejman Pireva, drejtor, është njëra nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e zhvillimit të kësaj biblioteke, duke premtuar se do të fillojë menjëherë, sipas prioriteteve, në përpunimin e koleksioneve të kësaj biblioteke.

Në këtë ceremoni solemne, z. Sali Bashota, drejtor i BKUK-së, premtoi përkrahjen profesionale që do t'i jepet kësaj biblioteke në planifikimin dhe dinamikën që parashihet për përpunimin e fondit bibliotekar në këtë Program.

## Mbahen trajnime në Kompaninë Ex-Libris për stafin udhëheqës të BKUK-së

Londër, 24-29 mars 2008

Më ndihmën e Projektit të OSBE-së për përmirësimin e cilësisë në BKUK, në kompaninë Ex-Libris në Londër kanë qëndruara në një aktivitet trajnues - për zhvillimin e njohurive në Programin e automatizuar bibliotekar Aleph 500, Ramush Zeka, shef i Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Bukurije Haliti, shefe e Departamentit të Katalogimit në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Në këtë aktivitet trajnues, udhëheqësit e BKUK-së kanë përfutuar njohuri në fushën e ndërtimit të rrjetit dhe të menaxhimit të Programit të integruar bibliotekar Aleph 500.

## ALEPH 500 - në Bibliotekën Ndërkomunale "Latif Berisha" në Mitrovicë

Mitrovicë, 21 mars 2008

Edhe në Bibliotekën Ndërkomunale "Latif Berisha" në Mitrovicë, më 21 mars 2008, u instalua licenca e parë e Programit Aleph 500. Nga drejtori i kësaj biblioteke - Hajrullah Mustafa, vlerësohet kontributi i BKUK-së për ndihmën në implementimin e Programit në bibliotekat Ndërkomunale të Kosovës, duke krijuar cilësi - në përputhje me zhvillimet moderne në fushë të bibliotekarisë në katalogim dhe klasifikim, si dhe në kërkimin e njësive bib-

liotekare nga përdoruesit.

Në këtë ceremoni solemne, z. Sali Bashota, drejtor i BKUK-së, ka treguar rëndësinë që ka për bibliotekat dhe hulumtimet, krijimi i katalogut të përbashkët online në Kosovë, nëpërmjet këtij programi. Ai premtoi përkrahje për stafin profesional të bibliotekës në fushën e Programi Aleph 500.

Në këtë akt solemn morën pjesë edhe strukturat komunale të Mitrovicës, të cilat premtuan mbështetjen e tyre në aktivitetet e ardhshme të bibliotekës.

## U mbajt takimi i parë i Këshillit Kombëtar të Bibliotekave

Prishtinë, 28 mars 2008

Më ftesën e ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Skënder Hyseni, më 28 mars u mbajt takimi i parë konstituiv i Këshillit Kombëtar të Bibliotekave, në përbërje të plotë. Këshilli trajtojë tema të rëndësishme nga Bibliotekat, si: gjendja aktuale në bibliotekat në Kosovë dhe çështjet e zhvillimit të koleksioneve nëpërmjet blerjes. Pas një debati të gjerë për këto çështje, janë formuar grupet punuese që do të identifikojë problemet e infrastrukturës në Bibliotekat e Kosovës dhe çështjen e pasurimit të fondeve të bibliotekave, përkatësisht përcaktimin e kriterëve të pasurimit. Pas raportit dhe analizës që do të bëjnë këto grupe punuese, do të përcaktohen prioritetet e investimeve në fusha të caktuara. *Izet Abdyli*

## BKUK përfaqësohet në eIFL-IP Global Conference 2008

Stamboll, 4 - 5 prill 2008

Në Stamboll, më datën 4 - prill 2008, është mbajtur konferenca me titull: "eIFL-IP Global Conference 2008". Në këtë konferencë, në të cilën morën pjesë përfaqësues të mëse 50 shteteve nga Evropa Lindore, shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik, Azia, Afrika, ishte i ftuar edhe përfaqësuesi nga Kosova i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - Ramush Zeka, shef i Departamentit të Teknologjisë Informative.

Tema bosht e konferencës ishte "Digjitalizimi dhe e drejta e autorit në shërbimet bibliotekare". Gjatë dy ditëve, sa ka zgjatur Konferenca, është diskutuar dhe janë shkëmbyer përvoja që lidhen me ndryshimet e mëdha në fushën e teknologjisë informative, duke shprehur nevojën që të punohet më shumë në arsimimin e mëtutjeshëm të bibliotekarëve, por edhe të shoqërisë në përgjithësi, në përvojat digjitale të informacionit.

## TAHIR FONIQI, KËRKIME BIBLIOGRAFIKE, BKUK, PRISHTINË 2008.

**M**r. Tahir Fonqi e pasuron literaturën e fushës së bibliografisë me librin e tij më të ri me titull: “Kërkime bibliografike”, botuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2008.

Libri përfshin një gamë të gjerë temash nga fusha e bibliografisë. Përmes këtij libri lexuesi njihet me historikun e fillimit të veprimtarisë bibliografike te shqiptarët në përgjithësi dhe të Kosovës në veçanti. Nga mënyra e trajtimit të temave të shumta dhe me rëndësi, ky botim mund të quhet njëkohësisht një histori, kritikë dhe teori për bibliografinë shqiptare.

Mr. Tahir Fonqi, si një njohës i mirë edhe i fushës së letërsisë shqipe, në këtë botim nxjerrë në dritë kontributin e një numri të madh të studiuesve shqiptarë dhënë në fushën e botimit të bibliografive, si ato të hartuara në formë të artikujve ashtu edhe të atyre në formë të monografive.

Në pjesën e fundit të librit është një intervistë e autorit dhënë gazetës së përditshme “Epoka e Re” në të cilën shpreh pikëpamjet e veta për rrjedhat e kulturës dhe të bibliografisë në Kosovë, si dhe janë dhënë të dhëna bio-bibliografike të autorit.



## JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË, 5 (16 - 21 PRILL - APRIL 2007) (BKUK BOTIME TË VEÇANTA; 13: JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË; 5), BKUK, PRISHTINË 2008.

**B**otimi i veçantë, Java e Bibliotekës në Kosovë 5, Prishtinë 2008, është një përmbledhje punimesh të prezantuar gjatë këtij manifestime tradicional me karakter profesional e kulturor i organizuar për të pestën herë nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare Kosovës.

Ky botim, që përmbledh punimet e autorëve të dijeve dhe kulturave të ndryshme, të prezantuar gjatë Javës së Bibliotekës, jep preokupimet, idetë dhe strategjitë në zhvillimin kulturës dhe të bibliotekave në këtë epokë, duke dhënë shumë përgjigje që opinioni bibliotekar i kërkon sot - në kushtet e zhvillimit të shkencave të informacionit.

Në botimin e Edicionit të Pestë të Javës së Bibliotekës në Kosovë, veçohen ligjëratat e ekspertëve dhe bibliotekarëve ndërkombëtarë, si të: Michael Kaplan, drejtor për Produkte Digjitalë (Ex Libris, SHBA), për programet bibliografike, katalogët përmbledhës, dhe ata kombëtarë; menaxhimi i përmbajtjeve digjitale për koleksionet e depoziturave për trashëgiminë kulturore dhe institucionale; ligjëratat e Mario Gonzalez, drejtor Ekzekutiv i Bibliotekës Greenwich (SHBA), për çështje thelbësore të administrimit të bibliotekave; filozofinë dhe rolin e bibliotekave publike; bibliotekat publike në epokën e informacionit, bibliotekat në shoqëri shumë-etnike etj.

Në këtë botim, vend të veçantë zënë edhe punimet e disa sesioneve me temat bosht: “Zhvillimi i Qendrës së Bibliotekës Universitare”; “Kujtesa e Kosovës - projekt i BKUK-së”; “Perspektiva e burimeve elektronike në Kosovë”; “Llojet e veprimtarive dhe të aktiviteteve të bibliotekave publike” dhe “Krist Maloki në Kosovë”.



Gjon Berisha